FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 23

Tiranë – E mërkurë, 26 shkurt 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 1/2020 datë 30.1.2020	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 10, datë 18.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për disa shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, 'Për tatimin mbi të ardhurat'", të ndryshuar.....	1871
Ligj nr. 2/2020 datë 30.1.2020	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 11,datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018 'Për buxhetin e vitit 2019'", të ndryshuar.....	1871
Ligj nr. 3/2020 datë 30.1.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar.....	1871
Ligj nr. 4/2020 datë 30.1.2020	Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare.....	1873
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 19.2.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 837, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020".....	1878
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 169, datë 20.2.2020	Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme.....	1959
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 66, datë 24.2.2020	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, "Udha e Shkronjave", Tiranë.....	1962
Kërkesë e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1996/1, datë 21.2.2020	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rikonstruksion sheshi 'Ismail Qemali' dhe rruga 'Veterani', Bashkia Pogradec".....	1963

LIGJ
Nr. 1/2020

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 10, DATË 18.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, 'PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 10, datë 18.12.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për disa shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, 'Për tatimin mbi të ardhurat'", të ndryshuar.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 30.1.2020.

LIGJ
Nr. 2/2020

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 11, DATË 24.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 99/2018 'PËR BUXHETIN E VITIT 2019'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 11, datë 24.12.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018 'Për buxhetin e vitit 2019'", të ndryshuar.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 30.1.2020.

LIGJ
Nr. 3/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8402, DATË 10.9.1998, "PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Kudo në ligj bëhen këto zëvendësime të termave:

a) "Investitor" me "Zhvillues".

b) "Leje shfrytëzimi" me "Certifikatë përdorimi".

c) "Procesverbal kolaudimi" me "Akt kolaudimi".

ç) "Autoriteti përkatës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit" me "Autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit".

d) "Autoriteti përkatës i planifikimit" me "Autoriteti përgjegjës i planifikimit të territorit".

dh) "Zyra e urbanistikës e njësisë vendore përkatëse" dhe "Autoriteti përkatës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit të njësisë vendore" me "Autoriteti vendor i zhvillimit të territorit".

e) "Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme" me "Agjencia Shtetërore e Kadastrës".

Neni 2

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 4/1

Të gjitha objektet, të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar, i nënshtrohen procesit të auditimit teknik. Rregullat për mënyrën se si do të zbatohet auditimi dhe cilat do të jenë subjektet që do ta kryejnë atë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Me "auditim teknik" kuptohet aktekspertiza e thelluar që vlerëson gjendjen teknike të një objekti dhe kapacitetet e tij mbajtëse.".

Neni 3

Neni 6 riformulohet si më poshtë:

"Neni 6

Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë;

c) objektet me akses publik.

Me "objekte me akses publik", sipas këtij neni, do të kuptohen të gjitha objektet, ku, pavarësisht statusit të pronësisë së tyre, qytetarët kanë akses të lirë hyrjeje, si: kinema, teatro, stadiume, markete etj.".

Neni 4

Për të gjitha ndërtimet me vlerë mbi 100 milion lekë, zhvilluesi kryen dhe mban në fuqi, për të gjithë kohën e ndërtimit të objektit, sigurimin e detyrueshëm nga rreziqet për punimet e ndërtimit. Elementet e sigurimit të detyrueshëm dhe rregullat e sigurimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 2, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe aktin nënligjor në zbatim të nenit 4, brenda 10 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 30.1.2020.

LIGJ
Nr. 4/2020

PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARIVE FINANCIARE[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave në lidhje me:

a) shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare, në zbatim të standardit të përbashkët të raportimit dhe marrëveshjes shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare;

b) detyrimin e institucioneve financiare raportuese për mbledhjen dhe raportimin e informacioneve të caktuara financiare pranë Autoritetit Kompetent, në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit;

c) përcaktimin e termave dhe të kushteve të përgjithshme, që lidhen me grumbullimin, përpunimin, përditësimin, bashkëveprimin, përqasjen, ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e informacionit, në lidhje me shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare në çështjet tatimore;

ç) të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kompetent për të siguruar zbatimin efektiv dhe përputhshmërinë me Standardin e Përbashkët të Raportimit, duke përfshirë marrjen dhe përdorimin e informacionit.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj synon sigurimin e zbatimit të Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështje Tatimore, të marrëveshjes shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare, për shmangien e mashtrimit tatimor dhe të evazionit fiskal, si dhe përmirësimin e pajtueshmërisë tatimore kombëtare e ndërkombëtare.

Neni 3
Parim i përgjithshëm

Shkëmbimi automatik i informacionit të llogarive financiare bëhet duke zbatuar dispozitat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

Neni 4
Subjektet

Subjekte të këtij ligji janë institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë, që ngarkohen për raportimin e llogarive të raportueshme, të mbajtura nga persona të raportueshëm, sipas dispozitave të vendosura në këtë ligj.

Neni 5
Përkufizime

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Autoriteti Kompetent" është administrata tatimore, e ngarkuar nga ky ligj për mbledhjen e informacionit nga institucionet financiare raportuese dhe për shkëmbimin automatik me juridiksionet e tjera, në përputhje me marrëveshjen shumëpalëshe në këtë fushë;

b) "Institucion financiar në Republikën e Shqipërisë", është:

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2011/16/BE, datë 15 shkurt 2011, "Mbi bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve dhe shfuqizimin e Direktivës 77/799/KEE", të ndryshuar. Numri CELEX 32011L0016, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.64, datë 11.3.2011, faqe 1-12.*

i. çdo institucion financiar rezident në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të çdo dege të atij institucioni financiar, që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ii. çdo degë e një institucioni financiar jorezident në Republikën e Shqipërisë, nëse kjo degë është e vendosur në Republikën e Shqipërisë;

iii. çdo institucion kujdestarie, institucion depozitues, shoqëritë e investimit ose një kompani e specifikuar sigurimi, sipas përcaktimeve të Standardit të Përbashkët të Raportimit;

c) "Institucioni financiar raportues" është çdo institucion financiar në Republikën e Shqipërisë që ka detyrimin të raportojë veprimtarinë financiare të klientëve pranë administratës tatimore;

ç) "Juridiksion i raportueshëm" është një juridiksion i identifikuar në listën e publikuar, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të nxjerra për zbatimin e këtij ligji;

d) "Llogari e raportueshme" është një llogari e mbajtur nga institucioni financiar raportues, e cila, sipas procedurave të vigjilencës së duhur, në përputhje me Standardet e Përbashkëta të Raportimit, është identifikuar si një llogari që mbahet nga një ose më shumë persona të raportueshëm në lidhje me juridiksionin tjetër ose nga një njësi ekonomike jofinanciare pasive, me një ose shumë persona kontrollues, të cilët konsiderohen persona të raportueshëm në lidhje me juridiksionin tjetër;

dh) "Marrëveshje" është marrëveshja shumëpalëshe e Autoritetit Kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare, e miratuar me vendimin nr. 178, datë 9.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e marrëveshjes shumëpalëshe, të Autoritetit Kompetent, për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare";

e) "Ofruesi i shërbimit palë e tretë" është personi, i cili mbledh, mban dhe raporton tek Autoriteti Kompetent informacionin e llogarive të raportueshme për një institucion financiar raportues;

ë) "Person i raportueshëm" është një individ ose njësi ekonomike, që është identifikuar si i/e tillë nga një institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë, rezident i një juridiksioni tjetër, sipas procedurave të vigjilencës së duhur, në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit;

f) "Standard i Përbashkët i Raportimit" është standardi i vendosur nga Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) për informacionin që do të raportohet nga institucionet financiare dhe që do të shkëmbehet me juridiksionet përkatëse, në të cilin përfshihet dhe Komentari;

g) "Vigjilenca e duhur" janë procedurat e përcaktuara për të identifikuar llogaritë e raportueshme, që mbahen nga personat e raportueshëm;

gj) "Komentari" është interpretim i detajuar i çdo seksioni të Marrëveshjes së Autoritetit Kompetent dhe Standardit të Përbashkët të Raportimit, që synon të sigurojë zbatimin e duhur të tyre në të gjitha juridiksionet, si dhe të shmangë krijimin e kostove të panevojshme për institucionet financiare, veçanërisht për ato institucione që i përkasin më shumë se një juridiksioni.

2. Çdo term tjetër, i përcaktuar ndryshe në këtë ligj ose në vendimin e Këshillit të Ministrave të nxjerrë në zbatim të tij, do të ketë kuptimin që ai ka në atë moment, sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe në përputhje me kuptimin e përcaktuar në Standardin e Përbashkët të Raportimit.

KREU II
DETYRIMI PËR RAPORTIM

Neni 6
Raportimi tek Autoriteti Kompetent

1. Çdo institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë i raporton Autoritetit Kompetent informacionin mbi llogaritë e raportueshme vjetore, të specifikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda datës 30 maj të vitit vijues, për të cilin mblidhet informacioni, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji.

2. Nëse institucioni financiar raportues, pas aplikimit të procedurave të vigjilencës së duhur, të përcaktuara në nenin 7, të këtij ligji, për një vit kalendarik nuk identifikon asnjë llogari si llogari të raportueshme, dërgon brenda afatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, pranë Autoritetit Kompetent, një deklaratë, e cila konfirmon mospasjen e një llogarie të raportueshme për vitin raportues.

3. Informacioni duhet të dërgohet elektronikisht, sipas një formati të standardizuar, duke përdorur teknologjinë e përshtatshme, në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 7
Vigjilenca e duhur

1. Për qëllim të nenit 6, të këtij ligji, institucionet financiare raportuese në Shqipëri duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e vigjilencës së duhur, të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, përfshirë edhe mbledhjen e vetëdeklarimeve për të gjitha llogaritë financiare të raportueshme, subjekte të këtij ligji.

2. Institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë kanë detyrimin të informojnë mbajtësit e llogarive të raportueshme për përpunimin e të dhënave të tyre personale, në kuadër të procesit të vigjilencës së duhur dhe detyrimit të raportimit, të kryer në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, përpara fillimit të procesit të raportimit dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 8
Ndarja e informacionit brenda të njëjtit grup ose me ofruesit e shërbimit palë e tretë

1. Institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë mund të ndajnë me ofruesit e shërbimeve, palë e tretë, ose me institucione të tjera financiare, që janë pjesë e të njëjtit grup, dokumentacionin dhe informacionet e mbledhura në lidhje me mbajtësit e llogarive të raportueshme, me qëllim përmbushjen e mbledhjes së të dhënave, të raportimit dhe rregullave për vigjilencën e duhur, të parashikuara nga nenet 6 dhe 7, të këtij ligji.

2. Ofruesit e shërbimit, palë e tretë, që mbajnë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për të bërë të mundur mbledhjen e të dhënave, procedurën e vigjilencës së duhur dhe detyrimet e raportimit, të përmendura nga nenet 6 e 7, të këtij ligji, mundet që, për qëllime të pajtueshmërisë së institucioneve të tilla financiare me detyrimet e lartpërmendura, të ndajnë informacionin dhe dokumentacionin përkatës që disponojnë me institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë.

3. Institucioni financiar raportues është përgjegjës për raportimin dhe zbatimin e rregullave të vigjilencës së duhur, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 9
Detyrat dhe kompetencat e Autoritetit Kompetent

1. Autoriteti Kompetent, nëpërmjet strukturave të tij të varësisë, mund të kërkojë informacion, nga çdo institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë. Me lajmërim paraprak, ai mund të hyjë në ambientet ku ushtrohet veprimtaria ekonomike e tij, me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimit të përcaktuar me këtë ligj.

2. Brenda 15 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës me shkrim të Autoritetit Kompetent, institucioni financiar raportues i vë në dispozicion regjistrimet apo të dhënat e mbajtura, sipas nenit 10, të këtij ligji, si dhe çdo dokument tjetër që kërkohet për të kryer verifikimin e përmbushjes së detyrimit të përcaktuar me këtë ligj.

3. Me kërkesë të autoritetit kompetent, një institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë duhet të japë shpjegime shtesë. Informacioni shtesë, veç detyrimeve të tjera, përmban:

a) plotësimin, nënshkrimin dhe kthimin e pyetësorëve ose kërkesave të tjera me shkrim për informacion nga Autoriteti Kompetent brenda 15 ditëve pune, nga data e marrjes së kërkesës;

b) takimin me punonjësit e Autoritetit Kompetent gjatë orarit të punës, dhënien e përgjigjeve për pyetjet e adresuara, si dhe të informacionit lidhur me zbatimin e këtij ligji.

4. Autoriteti Kompetent mund të njoftojë institucionin financiar kur ka arsye të besojë se një gabim mund të ketë çuar në informacione të pasakta ose të paplota, apo nëse raportimi nuk është në pajtim me kërkesat e zbatueshme dhe procedurat e vigjilencës së duhur, në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit.

Neni 10
Mbajtja e të dhënave dhe detyrimi për ruajtjen e tyre

1. Institucioni financiar raportues në Republikën e Shqipërisë duhet të krijojë, të mbajë dhe të dokumentojë procedurat e vigjilencës së duhur, në zbatim të këtij ligji, të cilat janë hartuar për të identifikuar llogaritë e raportueshme të mbajtura nga institucione të tilla financiare.

2. Institucioni financiar raportues:

a) mban regjistrimet që institucioni merr ose krijon, me qëllim përmbushjen e Standardit të Përbashkët të Raportimit, rregullave dhe procedurave, përfshirë vetëdeklarimet, hapat e ndërmarrë për identifikimin e llogarive të raportueshme dhe të dëshmive të dokumentuara. Të dhëna të tilla mbahen në formë elektronike ose dokument letër;

b) i mban këto të dhëna për një periudhë prej, të paktën, pesë vitesh, pas përfundimit të periudhës brenda së cilës institucioni duhet të raportojë informacionin e kërkuar për raportim, sipas Standardit të Përbashkët të Raportimit. Me përfundimin e këtij afati këto të dhëna shkatërrohen;

c) merr masat e nevojshme teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e të dhënave personale, që përpunohen në kuadër të këtij ligji.

3. Nëse këto regjistrime mbahen në një gjuhë tjetër, përveç asaj shqipe, në bazë të kërkesës së Autoritetit Kompetent, institucioni financiar raportues në Republikën e Shqipërisë duhet të sigurojë përkthim të tyre në gjuhën shqipe.

Neni 11
Shkëmbimi i informacionit mbi llogaritë e raportueshme

Në përputhje me dispozitat e Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore, si dhe bazuar në rregullat e raportimit dhe të vigjilencës së duhur, në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit, Autoriteti Kompetent shkëmben, me juridiksione të tjera kompetente, brenda 9-mujorit të çdo viti dhe në mënyrë automatike, informacionet e marra në bazë të procedurave dhe rregullave të specifikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

KREU III
SANKSIONET DHE ANKIMI ADMINISTRATIV

Neni 12
Kundërvajtjet administrative

1. Veprimet ose mosveprimet e kryera nga institucionet financiare raportuese apo persona të tjerë përgjegjës, të cilat janë në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) mosdorëzimi në afat i informacionit të detyrueshëm për t'u raportuar, i përcaktuar sipas këtij ligji, 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

b) dorëzimi i pasaktë i informacionit të detyrueshëm për t'u raportuar, jo në përputhje me nevojën dhe formën e përcaktuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

c) mosdhënia e informacionit të kërkuar nga çdo mbajtës i llogarive të raportueshme ose person tjetër përgjegjës, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, përveç nëse ky informacion ka të bëjë me një person të tretë dhe provohet se mosveprimi nuk ishte i qëllimshëm, dënohet me 1 000 000 (një milion) lekë gjobë;

ç) kryerja e deklarimit të rremë nga çdo mbajtës i llogarive të raportueshme ose person tjetër përgjegjës, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, dënohet me 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë gjobë;

d) pengimi nga personat përgjegjës, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me qëllim mosushtrimin e të drejtave dhe detyrave të Autoritetit Kompetent, të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, dënohet me 1 000 000 (një milion) lekë gjobë;

dh) zbatimi në mënyrë të gabuar i rregullave të vendosura mbi vigjilencën e duhur, si pasojë e neglizhencës nga personi që ka për detyrë t'i zbatojë ato dënohet me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë;

e) kryerja me dashje e veprimeve në kundërshtim me rregullat e vendosura mbi vigjilencën e duhur, nga subjektet përgjegjëse, dënohet me 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë gjobë.

2. Për raste të tjera kundërvajtjesh administrative, të paparashikuara në këtë ligj, zbatohen dispozitat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13
Ankimi

Subjektet e këtij ligji kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit apo veprimit të Autoriteti Kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14
Rregulli kundër shmangies

Institucioni financiar, ndërmjetësi, ofruesi i shërbimit apo çdo person tjetër, që hyn në një marrëveshje ose angazhohet në një praktikë, që synon të shmangë apo anashkalojë detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, konsiderohet subjekt i këtyre detyrimeve, pavarësisht marrëveshjes së lidhur apo angazhimit në këtë praktikë.

KREU IV
KONFIDENCIALITETI DHE SIGURIMI I TË DHËNAVE

Neni 15
Konfidencialiteti

1. Informacioni i siguruar nga institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë është konfidencial.

2. Çdo punonjës i Autoritetit Kompetent, institucionit financiar raportues dhe çdo funksionar publik, që ka akses në të dhënat personale që përpunohen në kuadër të këtij ligji, ka detyrimin që të nënshkruajë deklaratën e konfidencialitetit, e cila administrohet nga institucionet përkatëse, në cilësinë e punëdhënësit.

3. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pasi zyrtarët ose punonjësit nuk janë më të punësuar nga Autoriteti Kompetent, institucioni financiar raportues apo institucioni përkatës.

4. Informacioni i marrë nga autoritetet kompetente të huaja duhet të mbahet konfidencial, në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit dhe legjislacionin vendas.

Neni 16
Siguria e të dhënave

Përpunimi i të dhënave personale, në kuadër të procesit të shkëmbimit automatik të informacionit të llogarive financiare për çështje tatimore, kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 17
Interpretimi

Dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij interpretohen në përputhje me Komentarin e Standardit të Përbashkët të Raportimit.

Neni 18
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7, 8, 11, 12 dhe 14, të këtij ligji, jo më vonë se 3 muaj nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 19
Dispozita kalimtare

1. Përjashtimisht për raportimin e parë, institucioni financiar raportues, pas aplikimit të procedurave të vigjilencës së duhur, raporton brenda datës 31 korrik 2020 për të gjitha llogaritë e raportueshme ekzistuese në datën 1.1.2019, si dhe llogaritë e raportueshme të hapura përgjatë vitit 2019, sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, të këtij ligji.

2. Për raportimet në vitet pasuese, institucioni financiar raportues raporton pranë administratës tatimore brenda datës 30 maj, për llogaritë e raportueshme të vitit kalendarik paraardhës.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 30.1.2020.

VENDIM
Nr. 150, datë 19.2.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 837, DATË 24.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRGJITHSHËM ANALITIK TË PROJEKTAKTEVE QË DO TË PARAQITEN PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN E MINISTRAVE GJATË VITIT 2020"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Tabelat me emërtimet e mëposhtme bashkëlidhur vendimit nr. 837, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen, përkatësisht, me tabelat me të njëjtin emërtim që i bashkëlidhen këtij vendimi:

- Kryeministri/zëvendëskryeministri;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Kulturës;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2020
Kryeministri/zëvendëskryeministri

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017–2021 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë"	Projektligj	Kryeministri/zëvendëskryeministri (ADISA)	Katërmujori III	Përmirësimi i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të ADISA-s, si dhe harmonizimin me përcaktimet e K.Pr.A dhe Direktivës së BE-së 2006/123 / EC të datës 12 dhjetor 2006, "Për shërbimet në tregun e brendshëm".	1. Saktësimin dhe unifikimin e terminologjisë së përdorur në përcaktimet aktuale të ligjit; 2. Rregullimin e varësisë, statusit, organizimit dhe kompetencave të ADISA-s dhe organeve drejtuese të saj; 3. Përcaktimi në mënyrë shteruese i formave, mënyrave dhe kanaleve nëpërmjet të cilave ofrohen shërbimet publike në sportel; 4. Saktësim i procedurës, afateve dhe përcaktimeve lidhur me trajtimin e ankesave apo vendosjen e tarifave për shërbimin e sportelit.	Jo	Kreu III "Shërbimet publike", pika 3.1 "Shteti ligjor dhe drejtësia e re" të Programit politik qeverisës 2017–2021.	1. Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015–2020; 2. Dokumenti i politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri;	Ekonomike (jo); financiare (jo); sociale (jo); mjedisore (jo).
2	Për disa ndryshime në vendimin nr. 645, datë 14.9.2016 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara", të ndryshuar	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (ADISA)	Katërmujori I	Rritja e eficiencës së strukturës së ADISA-s dhe vijimi i shtrirjes së saj nëpërmjet sporteleve në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas planifikimeve të vitit 2020.	Riorganizimi i strukturës aktuale të ADISA-s duke kryer një ristrukturim në drejtoritë dhe sektorët përkatës, si dhe shtimin e ADISA-s në territor, në përputhje me planifikimet për vitin 2020.	Jo	Kreu III "Shërbimet publike", pika 3.1 "Shteti ligjor dhe drejtësia e re" të Programit politik qeverisës 2017–2021.	1. Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015–2020; 2. Dokumenti i politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri	Ekonomike (jo); financiare (jo); sociale (jo); mjedisore (jo).
3	VKM-ja për ndryshimin e VKM-së nr. 222, datë 26.4.2018, "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AKCESK)	Katërmujori I	Neni 6, pika 2, e ligjit nr. 2/2017, "Për sigurinë kibernetike".	Miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe infrastrukturave të rëndësishme	Po, është dërguar për t'u listuar si pjesë e kapitullit 10 "Shoqëria e informacionit dhe	n/a	n/a	Jo

	informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit					të informacionit	media",			
4	VKM-ja për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020–2025	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AKCESK)	Katërmujori II	Projektvendimi propozohet si një instrument rregullator në kuadër të politikave qeveritare të përcaktuara në "Dokumentin e Politikave për Sigurinë Kibernetike 2015–2017", miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 973, datë 2.12.2015.	Ky projektvendim ka si qëllim arritjen e një niveli të lartë të sigurisë në rrjetet dhe sistemet e informacionit në Shqipëri nëpërmjet miratimit të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2019–2025, e cila mundëson plotësimin e një baze ligjore, marrjes së masave teknike dhe organizative, vendosjes së objektivëve strategjikë sektorialë të përshtatshëm për sigurinë kibernetike dhe lehtësimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit mes subjekteve të ndryshme publike dhe private që administrojnë këto rrjete dhe sisteme.	Po, është parashikuar miratimi i tij në kuadër të kapitullit 10 "Shoqëria e informacionit dhe media"	n/a	Parashikohet miratimi i këtij projektakti, në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare	Po
5	Rregullore e brendshme e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (Qendra KKEDH)	Katërmujori I	Plotësimi i Qendrës me rregullore të brendshme, në përmbushje të detyrimit të VKM-së nr. 737, datë 13.12.2017	Mënyrën e funksionimit dhe organizimit të Qendrës dhe strukturave të saj politikëbërëse dhe ekzekutive.	Jo	jo	Në përputhje me Strategjinë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	Nuk ka
6	Për miratimin e Rregullores "Mbi mënyrën e funksionimit të Pikës së vetme të Kontaktit"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AKSHI)	Katërmujori II	Përafrimi i legjislacionit me Rregulloren (BE) 2018/1724 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 2 tetor 2018, për krijimin e një porte të vetme digjitale për të siguruar qasje në informacione, procedura dhe ndihmë dhe shërbime të zgjidhjes së problemeve dhe ndryshimin e Rregullores (BE)	Në zbatim të ligjit nr. 66/2016 "Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë", kjo rregullore do të përcaktojë: a) kërkesat e nevojshme funksionale, teknike dhe ligjore të Pikës së Vetme të Kontaktit për shërbime në Republikën e Shqipërisë (referuar në vijim si: PVK), si porta e vetme digjitale për t'u lehtësuar ofruesve dhe përfituesve të shërbimeve, aksesin në informacion, procedura elektronike dhe asistencë efektive në përfitimin e shërbimeve; b) përgjegjësinë e organeve kompetente për PVK-në dhe institucioneve ofruese të shërbimeve publike nëpërmjet PVK-së.	Kapitulli 3	N/A	Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015 - 2020	Jo

7	Mbi masat për një nivel të lartë të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AKSHI)	Katërmujori II	Përafrimi i legjislacionit me Direktivën e BE-së 2016/1148 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit lidhur me masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë së të rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në të gjithë Bashkimin.	Ky projektakt planifikohet të rregullojë kornizën kombëtare mbi sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit (kërkesat e sigurisë, njoftimin mbi incidentet etj.)	Jo, por do të parashikohet në kapitullin 10	N/A	Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015–2020	Jo
8	"Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, rinovimit, dokumenteve shoqëruese, formateve të miratimit në parim, lejes e autorizimit, kushteve të përgjithshme e të posaçme të lejeve e autorizimeve, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, si dhe afateve të vlefshmërisë".	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori I	Përmirësimi i procedurave të aplikimit për leje, autorizim, si dhe përcaktimin e dokumentacionit shoqërues që duhet të paraqesin subjektet kërkuese.	Përcakton formularin e aplikimit për leje/autorizim sipas veprimtarive të parashikuara në ligjin nr. 111/2012, dokumentacionit teknik e ligjor që duhet të plotësojë aplikuesi, afatet dhe procedurat e shqyrtimit të aplikimit, vendimmarrjes dhe afatet e vlefshmërisë së lejes/autorizimit	Jo	Jo	Jo	Jo
9	Për disa ndryshime në VKM-në nr. 221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori II	Projektvendimi është hartuar si kërkesë për plotësimin me aktet përkatëse nënligjore të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", si dhe është në vijim të miratimit të VKM-së "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor.....", të parashikuar në pikën 2.	Ky projektakt parashikon që shqyrtimi i kërkesave për leje/autorizim për përdorim burimi ujor, nëpërmjet sistemit elektronik të bëhet nga AMBU-ja	jo	jo	jo	jo
10	Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative, që lidhen me përdorimin apo shkarkimin e ujit dhe ndërtimin e objekteve a veprave ujore	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori III	Projektvendimi është hartuar si kërkesë për plotësimin me aktet përkatëse nënligjore të ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", si dhe është në vijim të miratimit të VKM-së "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor.....", të parashikuar në pikën 2.	Ky projektakt parashikon tarifat që duhet të paguajë çdo subjekt që aplikon për leje/autorizim për përdorim burimi, sipas llojit të veprimtarisë që kërkon të ushtrojë.	jo	jo	jo	jo
11	"Për miratimin e tarifave të përdorimit dhe shkarkimit të ujit"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori III	Projektvendimi është hartuar si kërkesë për plotësimin me aktet përkatëse nënligjore të ligjit nr. 111/2012, "Për	Ky projektakt parashikon tarifat që duhet të paguajë çdo subjekt për përdorimin e ujit dhe për	jo	jo	jo	jo

					menaxhimin e integruar të burimeve ujore", si dhe është në vijim të miratimit të VKM-së "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor.....", të parashikuar në pikën 2.	shkarkimet e lëngshme.				
12	"Për miratimin e kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e kadastrës kombëtare të burimeve ujore"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori III	Arsyet që kanë çuar në propozimin e këtij projektvendimi ka të bëjë me detyrimin e vendit tonë për përafrimin me kuadrin ligjor evropian, si dhe nevoja urgjente për krijimin e një inventari në nivel kombëtar të rezervave ujore, vendndodhjeve të tyre, sasisë dhe cilësisë së tyre.	Ky projektakt do të plotësojë kuadrin ligjor ekzistues në fushën e menaxhimit të burimeve ujore, dhe do të përcaktojë rregullat dhe procedurat për mbledhjen e organizuar të të dhënave logjikisht të lidhura e të mbledhura nga burime të ndryshme, të ruajtura dhe të formuluara në sistemin e kadastrës dhe në dispozicion për përdoruesit e burimeve ujore dhe institucionet e linjës, që veprojnë në fushën e ujërave.	jo	jo	jo	jo
13	"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 268, datë 6.4.2016, "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Ujit"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori I	Arsyet që kanë çuar në propozimin e këtij projektvendimi ka të bëjë me ndryshimet institucionale që ka sjellë ndryshimi i ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".	Ky projektakt do të bëjë ndryshimin e institucionit të STKKU-ë, si dhe të qartësojë procedurën e propozimit të akteve në KKU dhe në bashkërendimin e tyre.	jo	jo	jo	jo
14	"Për miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë, për forcimin e kapaciteteve të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori I	Nëpërmjet kësaj marrëveshje synohet që Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore të transformohet në një institucion efektiv dhe efikas, që përmbush plotësisht kompetencat e saj ligjore, detyrat dhe përgjegjësitë.	Në zbatim të marrëveshjes, SIDA do të mbështesë AMBU-në në procesin e hartimit të dokumenteve strategjike dhe të planifikimit, si dhe në përafrimin e legjislacionit të brendshëm me acquis të Bashkimit Evropian në kuadër të kapitullit 27, të negociatave.	jo	jo	jo	jo
15	"Për karakterizimin dhe statusin e ujërave nëntokësore"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projektakti synohet klasifikim i ujërave nëntokësore sipas statusit sasior dhe kimik	Po. Në kapitullin "Mjedisi"	jo	jo	jo
16	"Për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotje dhe dëmtimi i statusit të tyre"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projektakti synohet mbrojtja dhe përmirësimi i statusit të ujërave nëntokësore	Në kapitullin "Mjedisi"	jo	jo	jo

17	"Për planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori III	Nëpërmjet këtij akti synohet përcaktimi i mënyrës së hartimit të planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, si dhe i procedurave të miratimit të tij.	Ky projektakt përcakton se çfarë duhet të përmbajë një plan menaxhimi, masat që ndërmerren për hartimin e tij, si dhe procedurën e miratimit	Në kapitullin "Mjedisi"	jo	jo	jo
18	"Për karakterizimin e trupave ujorë sipërfaqësorë"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projektakti synohet klasifikim i ujërave sipërfaqësore sipas statusit kimik dhe ekologjik	Në kapitullin "Mjedisi"	jo	jo	jo
19	"Për krijimin e regjistrit të zonave të mbrojtura në basenet ujore"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projektakti synohet identifikimi dhe shpallja e zonave të mbrojtura mjedisore	Në kapitullin "Mjedisi"	jo	jo	jo
20	"Për statusin e ujërave sipërfaqësore"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projektakti synohet shpallja e statusit të ujërave si artificiale ose tepër të modifikuara	Në kapitullin "Mjedisi"	jo	jo	jo
21	Për elementet përbërëse të planeve të menaxhimit të baseneve ujore"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projektakti synohet përcaktimi i elementeve që duhet të përmbajë një plan menaxhimi i basenit ujor	Në kapitullin "Mjedisi"	jo	jo	jo
22	"Për trajtimin e ujërave të ndotura urbane"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij akti synohet përcaktimi i kërkesave për grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotura urbane, me qëllim mbrojtjen e mjedisit nga efektet negative të tyre.	Në kapitullin "Mjedisi"	jo	jo	PO
23	Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Seman	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori I	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projektakti synohet miradministrimi i burimeve ujore të basenit ujor Drin–Bunë	Në kapitullin "Mjedisi"	jo	Po. VKM-ja nr. 73, datë 7.2.2018 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018–2027	Po
24	Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Drin–Bunë	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori I	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projektakti synohet miradministrimi i burimeve ujore të basenit ujor Drin–Bunë	Në kapitullin "Mjedisi"	jo	Po. VKM nr.73, datë 7.2.2018 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018–2027	Po
25	Ndryshimi i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, "Për prokurimin	Projektligj	Kryeministri/zëvendëskryeministri (APP)	Katërmujori II	Përshtatje me Direktivën e BE-së 2014/24; 2014/25	• Të përafrohet legjislacioni shqiptar me Acquis e BE-së, duke transpozuar ose adaptuar direktivat specifike, të cilat	Kapitulli i V i PKIE-së	Pika 2.1 "Stabiliteti makroekonomik", pika 3.1.1 "Administrata publike dhe	Strategjia Antikorrupsion, Strategjia për menaxhimin e financave publike dhe Reforma për	Jo

	publik"					mbulojnë procedurat e prokurimit në sektorin klasik, sektorial dhe direktivat e rishikimit administrativ; • Të përmirësohet ndjeshëm kuadri aktual rregullator në fushën e prokurimit publik; • Të lehtësohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë, në procedurat e prokurimit; • Të shmanget zvarritja e procesit të prokurimit, për shkak të tejzgjatjes së procesit të ankimit administrativ; • Prokurim i qëndrueshëm, në respektim të parimeve për mbrojtjen sociale dhe mjedisore; • Lehtësi në prokurimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike; • Rritja e performancës në implementimin e kontratave, nëpërmjet forcimit të monitorimit të këtij procesi.		digjitalizimi"	Administratën Publike	
26	VKM-ja nr. 914/2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (APP)	Katërmujori III	Përshtatje me ndryshimet që do të pësojë ligji i prokurimit publik	• Organizimi i procesit të prokurimit, • rregullat e përgjithshme të prokurimit, •procedurat e prokurimit, •procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të oferta, •monitorimi i zbatimit të kontratës etj. Të gjitha këto procese do të ndryshojnë si rezultat i ndryshimeve ligjore.	Jo	Pika 2.1 "Stabiliteti makroekonomik", pika 3.1.1 "Administrata Publike dhe digjitalizimi"	Strategjia Antikorrupsion, Strategjia për menaxhimin e financave publike dhe Reforma për Administratën Publike	Jo
27	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për prokurimin Publik	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (APP)	Katërmujori II	Përmirësimi i sistemit të prokurimit publik në Shqipëri	• Rritja e eficiencës së prokurimit publik, • rritja e kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit publik, • garantimi i integritetit në fushën e prokurimit publik, • rritja e konkurrencës në fushën e prokurimit publik •përmirësimi i sistemit elektronik të prokurimit	Kapitulli i V i PKIE-së	Pika 2.1 "Stabiliteti makroekonomik", pika 3.1.1 "Administrata Publike dhe digjitalizimi"	Strategjia Antikorrupsion, Strategjia për menaxhimin e financave publike dhe Reforma për Administratën Publike Plani Kombëtar për Integrimin Evropian	Jo
28	"Për modelin e kartelës së	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori I	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së	Të dhënat dhe elementet e kartelës së pasurisë së	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të	jo

	pasurisë së paluajtshme"				veprimtarisë së ASHK-së dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	paluajtshme		konkretisht me kreun 3, "Shërbimet publike" dhe konkretisht pika 3,1 shteti ligjor dhe drejtësia e re, paragrafi 2, 3.	zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012–2020 (kapitulli II)	
29	"Për rregullat e hollësishme për përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori I	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK-së dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Rregullat e përdorimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ruajtjen dhe administrimin e tyre	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun 3, "Shërbimet publike" dhe konkretisht pika 3,1 shteti ligjor dhe drejtësia e re, paragrafi 2, 3.	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale, Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012–2020 (kapitulli II)	jo
30	"Për modelin e certifikatës së pronësisë dhe të certifikatave për të drejtat reale mbi pasuritë e paluajtshme"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori I	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Të dhënat dhe elementet e certifikatës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun 3, "Shërbimet publike" dhe konkretisht pika 3,1 shteti ligjor dhe drejtësia e re, paragrafi 2, 3.	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012–2020 (kapitulli II)	jo
31	"Për rregullat dhe procedurat për ushtrimin e së drejtës nga personat juridikë/fizikë vendës apo të huaj për të pasur akses në sistemin elektronik"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori I	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK-së dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Rrethin e subjekteve që do të kenë të drejtën e aksesimit në sistemin elektronik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun 3, "Shërbimet publike" dhe konkretisht pika 3,1 shteti ligjor dhe drejtësia e re, paragrafi 2, 3.	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012–2020 (kapitulli II)	jo
32	"Për rregullat për procedurën e trajtimit të kërkesave nga ASHK-ja"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori I	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK-së dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Përcaktimi i rregullave, procedurave dhe afateve në trajtimin e kërkesave të subjekteve gjatë aplikimit në ASHK	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun 3, "Shërbimet publike" dhe konkretisht pika 3,1 shteti ligjor dhe drejtësia e re, paragrafi 2, 3.	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012–2020 (kapitulli II)	jo
33	" Për procedurat e hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori I	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK-së dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Përcaktimi i rregullave, procedurave dhe afateve në trajtimin e kërkesave të subjekteve që kanë titull pronësie, por nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun 3, "Shërbimet publike" dhe konkretisht pika 3,1 shteti ligjor dhe drejtësia e re, paragrafi 2, 3.	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012–2020 (kapitulli II)	jo
34	"Për rregullat e hollësishme për mënyrat dhe mjetet teknike-hartografike për realizimin e përmirësimit të regjistrit të pasurive të paluajtshme"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori I	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK-së dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Përcaktimi i rregullave, mënyrave, mjeteve për realizimin e procesit të përmirësimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun 3, "Shërbimet publike" dhe konkretisht pika 3,1 shteti ligjor dhe drejtësia e re,	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012–	jo

								paragrafi 2, 3.	2020 (kapitulli II)	
35	"Për regjistrimin e pemëve dhe të pasurive të tjera natyrore"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori I	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK-së dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Përcaktimi i rregullave dhe procedurave gjatë procedurës së regjistrimit të pemëve dhe pasurive të tjera natyrore në regjistrat e pasurive	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun 3, "Shërbimet publike" dhe konkretisht pika 3,1 shteti ligjor dhe drejtësia e re, paragrafi 2, 3.	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012–2020 (kapitulli II)	jo
36	"Për listën e shërbimeve kadastrale dhe tarifat e tyre"	Projektvendim	Kryeministri/zëvendëskryeministri (ASHK)	Katërmujori I	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK-së dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Përcaktimi i listës së shërbimeve që do të ofrojë ASHK-ja ndaj subjekteve dhe tarifat përkatëse të tyre	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun 3, "Shërbimet publike" dhe konkretisht pika 3,1 shteti ligjor dhe drejtësia e re, paragrafi 2, 3.	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012–2020 (kapitulli II)	po/ndikim financiar dhe social
28	Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin nr. 48/2018, 'Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë".	Projektligj	Ministria e Mbrojtjes	Katërmujori I	Përcaktimin e ligjit në lidhje me aplikimin me shkrim për pajisje me licenca/ autorizime/ certifikata etj. bie ndesh me ofrimin e shërbimeve online.	Ndryshimet do të përcaktojnë mundësinë e aplikantëve për të aplikuar online dhe për të marrë shërbimin e kërkuar online.	Jo	Jo	N/A	Po	
29	Projektligji "Për privatizimin e objekteve dhe sipërfaqeve ndërtimore nën objektet e dhëna për strehim, në inventar të Ministrisë së Mbrojtjes'".	Projektligj	Ministria e Mbrojtjes	Katërmujori I	Zgjidhja përfundimtare e problematikës shumëvjeçare të ushtarakëve që jetojnë në objekte të cilat u janë dhënë për strehim.	Përcaktimi i objekteve dhe personave të cilët kanë qenë pajisur me autorizim për strehimin në këto objekte dhe dhënia e mundësisë së privatizimit të këtyre objekteve prej tyre.	Jo	Jo	N/A	Po	
30	Projektligj "Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Operacionin "SENTINEL" në Ngushticën e Hormuzit, Gjiri Persik".	Projektligj	Ministria e Mbrojtjes	Katërmujori I	Marrjen e autorizimit nga Kuvendi për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin "Sentinel" në Ngushticën e Hormuzit, Gjiri Persik.	Përcaktimi i kohëzgjatjes së misionit, numrin e personelit ushtarak pjesëmarrës, dietat për ditët e qëndrimit, siguracioni shëndetësor etj.	Jo	Jo	N/A	Po	
31	Projektvendim "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 25.2.2015, 'Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Operacionin 'RSM', në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës, në kuadër të iniciativës së Kartës së Adriatikut, në Afganistan'"	Projektvendim	Ministria e Mbrojtjes	Katërmujori I	Shtyrja e afatit të pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin "RSM", në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës, në kuadër të iniciativës së Kartës së Adriatikut, në Afganistan	Kohëzgjatja e afatit të pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin "RSM", në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës, në kuadër të iniciativës së Kartës së Adriatikut, në Afganistan	Jo	Jo	N/A	Po	

32	Projektvendim "Për kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Vlorë, të një pjese të truallit funksional, brenda territorit të pronës nr. 912, me emërtim "Shtëpia e ushtarakëve", me vendndodhje në Vlorë, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar	Projektvendim	Ministria e Mbrojtjes	Katërmujori I	Heqjen nga përgjegjësia e administrimit të Ministrisë së Mbrojtjes të një sipërfaqe mbi të cilën Bashkia Vlorë ka ndërtuar një trotuar.	Kalimi i pronësisë mbi këtë sipërfaqe trualli nga Ministria e Mbrojtjes në Bashkinë Vlorë dhe heqja nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.	Jo	Jo	N/A	Po	
33	Projektvendim "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 13.7.2016, "Për pjesëmarrjen e një toge këmbësorie të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me mision, në Komandën e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Herat, në kuadër të operacionit të NATO-s "RSM", Afganistan"	Projektvendim	Ministria e Mbrojtjes	Katërmujori I	Shtyrja e afatit të pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Komandën e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Herat, në kuadër të operacionit të NATO-s "RSM", Afganistan".	Kohëzgjatja e afatit të pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Komandën e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Herat, në kuadër të operacionit të NATO-s "RSM", Afganistan".	Jo	Jo	N/A	Po	

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2020

MINISTRIA E KULTURËS

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017–2021 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për kushtet dhe kriteret e licencimit në kryerjen e veprimtarisë arkeologjike	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 136	Ky projektakt rregullon kushtet dhe kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, nënkategoritë e licencave, procedurat për dhënien, pezullimin ose revokimin e licencave, si dhe kuotizacioni vjetor i licencave.	JO	JO	JO	JO
2	Për përcaktimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme të kontratës së rijetëzimit	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 186	Ky projektakt rregullon kushtet që do të kenë kontratat e rijetëzimit, ku do të përcaktohen kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të tyre, si dhe kushtet teknike në rastet e ndërtimit të infrastrukturës përkatëse, ndërtesave dhe zonave të lira të zbulimeve arkeologjike.	JO	PO	JO	JO
3	Për miratimin e procedurave dhe kritereve të konkurrimit, formën e kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", nenet 178 dhe 184	Ky projektakt rregullon në mënyrë të detajuar kushtet dhe procedurat që ndjekin institucionet publike për dhënien në përdorim të pasurive kulturore që kanë në administrim, një subjekti të interesuar nëse garantohet përputhshmëria e qëllimit të përdorimit me destinacionin kulturor të pasurisë dhe dhënia në përdorim nuk cenon vlerat e saj si trashëgimi kulturore. Gjithashtu rregullon dhe procedurat e konkurrimit për dhënien në përdorim të pasurive të paluajtshme kulturore në administrim të institucioneve qendrore ose vendore për qëllim rijetëzimi, për funksione administrative e social-kulturore, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore.	JO	PO	JO	JO
4	Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen dhe metodologjinë e përgatitjes së planeve të menaxhimit të pasurive të paluajtshme kulturore	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 46	Ky projektakt rregullon çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e metodologjisë së përgatitjes, përmbajtjes, strukturës dhe shtrirjes së planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme.	JO	PO	JO	JO
5	Projektvendim "Për përcaktimin e tarifave për të ardhurat e krijuara nga veprimtaria kryesore e Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor"	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe Kulturën"	Ky projektvendim do të miratojë tarifat (biletat dhe shërbimet parësore) që ofron Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.	JO	JO	JO	PO; miratimi i këtij akti rrit të ardhurat nga institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës
6	Për kushtet dhe kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, nënkategoritë e licencave, si dhe procedurat për dhënien, pezullimin ose revokimin e licencave, kuotizacionin vjetor të licencave në projektim dhe zbatim të ndërhyrjeve në pasuritë kulturore	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" pika 4, e nenit 82	Ky projektakt do të përcaktojë kushtet dhe kriteret e posaçme, dokumentet shoqëruese, nënkategoritë e licencave në fushën e projektimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve në pasuritë kulturore.	JO	JO	JO	JO
7	Për përcaktimin e rregullave të administrimit të Fondit Kombëtar të Kujdesit për	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018 "Për	Ky projektakt i rëndësishëm rregullon mënyrën e administrimit të "Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore" në formën e një fondi financiar publik, që mbështet politikën kombëtare të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore materiale me qëllim	JO	JO	JO	JO

	Trashëgiminë Kulturore				trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 19	sigurimin e ruajtjes së vlerave kulturore materiale.				
8	Projektvendimi "Për deklarimin e Qendrës Historike të qytetit të Shkodrës, përcaktimit të zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre"	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim i ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" të pikës 2, të nenit 5, të germës "a", pika 3, e nenit 9, dhe nën paragrafit "ii", të pikës 3/b, të nenit 53, pikës 3, të nenit 62	Ky projektvendim ka për qëllim miratimin e deklarimit të Qendrës Historike të qytetit të Shkodrës dhe zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre. Zonimi i ri së bashku me Planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e Qendrës Historike dhe zonës mbrojtëse të saj do të jetë një hap i ri cilësor për ruajtjen e vlerave historiko-kulturore, mbrojtjen, restaurimin dhe miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Shkodrës, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky plan synon zhvillimin e mëtejshëm territorial, ekonomik dhe kulturor të kësaj zone dhe do jetë një shtysë për zhvillimin e turizmit kulturor, duke krijuar bazat e nevojshme për një zhvillim të qëndrueshëm.	JO	JO	JO	JO
9	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr. 4/239, me vendndodhje në zonën kadastrale 8260, me emërtimin "Qendra e Realizimit të Veprave të Artit"	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Vjen si pasojë e mbylljes së Qendrës së Realizimit të Veprave të Artit, institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 26.12.2018, "Për shfuqizimin e vendimit nr. 646, datë 29.12.1999, të Këshillit të Ministrave "Për mbështetjen financiare të veprimtarisë së Qendrës së Realizimit të Veprave të Artit", si dhe krijimin e Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit, "Tirana", institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, i krijuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 45, datë 3.5.2019, "Për krijimin e Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit "Tirana".	Kalim në pronësi të Bashkisë Tiranë të pasurisë së paluajtshme, regjistruar pranë ZVRPP-së me nr. 4/239-N e ndodhur në zonën kadastrale 8260, me sip. 348 m^2, me adresë: rruga "Muhamet Gjollesha".	JO	JO	JO	JO
10	Shtesë fondi për Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Ky projektvendim vjen si nevojë për realizimin e Festivalit Folklorik Kombëtar, të Gjirokastrës për promovimin dhe popullarizimin e vlerave më të mira muzikore, koreografike, etnografike të krijuara nga populli; si dhe pasqyrimin më të gjerë të të gjitha gjinive të folklorit dhe vlerave të tij.	Parashikohet shtesa e fondit e cilat do të vihet në dispozicion të aktiviteteve që do të realizohen për Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës.	JO	JO	JO	PO
11	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 245, datë 29.3.2017, "Për dhënien me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës së koncerteve të Pallatit të Kongreseve, Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Populloor	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Duke qenë se aktualisht projekti për rikonstruksionin e TKOBAP-it nuk ka përfunduar ende lind nevoja për ndryshimin e pikës 3 të VKM-së nr. 245, datë 29.3.2017, dhe në vijim për të mos penguar aktivitetet artistike parashikohet që shpenzimet për pagesën e qirasë së reduktuar të përballohen nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Kulturës.	Ndryshimi i pikës 3, të VKM-së nr. 245, datë 29.3.2017, "Për dhënien me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës së koncerteve të Pallatit të Kongreseve, Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Populloor", me qëllim që efektet e kësaj VKM-je të shtrihen edhe për vitin 2020.	JO	JO	JO	JO

12	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe Kulturën"	Projektligj	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Projektakti është parashikuar në programin e Qeverisë 2017–2021, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian dhe Kontratën e Performancës ndërmjet Ministrit të Kulturës dhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në funksion të mirëmenaxhimit të sistemit kulturor institucional e më gjerë. Synojmë rritjen graduale e në mënyrë të ndjeshme të cilësisë së produktit artistik, impaktit artistik, në vend dhe më gjerë. Synojmë gjithëpërfshirjen e grupeve të interesit në projektet artistike dhe veprimtarive me fokus art-kulturë. Riorganizimi i institucioneve të artit dhe kulturës, duke krijuar lehtësira në procedurat burokratike të prokurimit për aktivitetet artistike. 1. Krijimi i Këshillit Kombëtar të Artit; 2. Krijimi i fondacioneve të posaçme në fushën e artit; 3. Tregtia e veprave të artit dhe licencimi i tyre.	Ky akt është parashikuar në PIKE 2019–2021. Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura"	Projektakti është parashikuar në Programin Politik Qeverisës 2017–2021, dhe ka ardhur edhe si nevojë për ndryshim edhe nga kërkesat e institucioneve vendore, grupeve të interesit dhe Ministrisë së Kulturës në kuadër të zhvillimit të politikave për artin dhe kulturën	JO	Po ka ndikim social. Thjeshtim i procedurave burokratike në administrimin e fondit të destinuar për kulturën në të gjithë sistemin 2. Fleksibilitet në realizimin e projekteve kulturore duke vënë fokusin në rritjen e cilësisë artistike, Krijimi i formave të reja të administrimit dhe menaxhimit të institucioneve të artit. Tregtia e Veprave të Artit dhe licencimi i tyre.
13	Projektligji "Për krijimin dhe funksionimin e zonës së veçantë të zhvillimit artistik dhe kulturor në Pallatin e Brigadave	Projektligj	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Qëllimi i këtij projektligji është promovimi i investimeve në fushën kulturore dhe artistike në territorin shqiptar dhe hapja e vendeve të reja të punës në këtë sektor. Nxitja dhe zhvillimi i sektorit të punësimit në fushën e artit dhe kulturës	Qëllimi i këtij projektligji është promovimi i investimeve në fushën kulturore dhe artistike në territorin shqiptar dhe hapja e vendeve të reja të punës në këtë sektor. Ky ligj rregullon themelimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e një zone të veçantë të zhvillimit artistik dhe kulturor në Pallatin e Brigadave, të drejtat dhe detyrimet e institucioneve përgjegjëse, Fondacionin "Pallati i Brigadave", operatorëve dhe përdoruesve, të cilët veprojnë në këtë zonë.	JO	JO	PO; Strategjia Kombëtare e kulturës, 2019–2025	PO
14	Për përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 1, e nenit 96	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor me qëllim përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin.	JO	JO	JO	JO
15	Për përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim të pasurisë kulturore	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", shkronja "c", e pikës 3, e nenit 171	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor për dhënien në administrim të pasurisë kulturore publike personave fizikë apo juridikë, publikë apo privatë, nëpërmjet procedurave publike.	JO	JO	JO	JO
16	Për miratimin e planit të menaxhimit për Butrintin	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 47	Ky projektakt rregullon miratimin e planit të Parku Kombëtar të Butrintit, në mbështetje të nenit 47, i cili do të përmbajë: objektivat dhe organizimin e menaxhimin, karakteristikat e përgjithshme të territorit të mbrojtur, përfshirjen e partnerëve në zbatimin e planit, sistemin e monitorimit në territorin e mbrojtur dhe sigurimin e masave të shpëtimit në rastet e emergjencave etj.	JO	PO	JO	JO
17	Për projektimin, zbatimin e punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e tyre	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 3, e nenit 72	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në fushën e licencave për zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse në monumentet e kulturës.	JO	JO	JO	JO
18	Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 1, e nenit 82	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në lidhjen me normat teknike që lidhen me ndërhyrjet në objektet pasuri kulturore me qëllim ruajtjen e tyre.	JO	JO	JO	JO
19	Për emërimin e drejtorit të Qendrës	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor 10 352, datë 18.11.2010, "Për	Ky projektvendim synon të emërojë drejtorin e Ri të institucionit publik të artit dhe kulturës.	JO	JO	JO	JO

	Kombëtare Kulturore për Fëmijë				artin dhe kulturën", i ndryshuar					
20	Për pensionet e disa profesioneve të vështira të artistëve	Projektligj	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Nëpërmjet këtij projektligji është synohet përfitimi i pensionit, në bazë të nivele të përcaktuara, të punonjësve artiste, konkretisht, artistë të baletit, artistët e valleve të asambleve shtetërore dhe private; akrobatë dhe gjimnastë të cirkut; solistë të operës, teatrove muzikalë dhe të asambleve shtetërore, koristët e operës, të teatrove muzikorë dhe të asambleve shtetërore; muzikantë të veglave të frymës të orkestrave dhe të bandave shtetërore, për shkak se konsiderohen profesione të vështira	Përfitimi i pensionit, në bazë të nivele të përcaktuara, të punonjësve artiste, konkretisht, artistë të baletit, artistët e valleve të asambleve shtetërore dhe private; akrobatë dhe gjimnastë të cirkut; solistë të operës, teatrove muzikalë dhe të asambleve shtetërore, koristët e operës, të teatrove muzikorë dhe të asambleve shtetërore; muzikantë të veglave të frymës të orkestrave dhe të bandave shtetërore.	JO	JO	JO	PO
21	Për miratimin e marrëveshjes së administrimit të Parkut Arkeologjik Butrint lidhur midis Ministrisë Kulturore dhe Fondacionit të Posaçëm	Projektligj	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 5, e nenit 172	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në fushën e lejeve për hulumtime arkeologjike.	JO	JO	JO	PO
22	Për procedurat e konkurrimit publik në rastet e kryerjes së investimeve me fonde publike në trashëgiminë kulturore	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 90	Ky projektakt synohen të rregullojë çështjet që do të kenë të bëjnë me parashikime, procedura, konkurrime publike për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje apo kolaudim në pasuritë kulturore, të cilët do të përjashtohen nga zbatimi i parashikimeve të ligjit mbi prokurimin.	JO	JO	JO	JO
23	Për përcaktimin e kufijve të Parkut Arkeologjik Durrës	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 1, nenit 212	Ky projektakt do të përcaktojë kufijtë e Parkut Arkeologjik Durrës.	JO	JO	JO	JO
24	Për kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifat e aplikimit dhe të kuotizacionit vjetor për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore. (Tregtia e pasurive kulturore.)	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" pika 3, e nenit 116	Ky projektakt plotëson kuadrin ligjor në fushën e licencimit për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore, konkretisht përcaktohen kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifat e aplikimit dhe tarifa e kuotizacionit vjetor.	JO	JO	JO	JO
25	Për procedurat e krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 1, e nenit 130	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor të krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura.	JO	PO	JO	JO
26	Për format dhe llojet e licencave të qarkullimit të lirë për eksportin e pasurive kulturore të luajtshme	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Projektakti është parashikuar në PKIE 2018–2020 (faqe 191–192)	Ky projektvendim del në zbatim të përafrimit që do të bëhet me Rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) nr.1081/2012, 9 nëntor 2012 për qëllimet e rregullores së Këshillit (BE) nr. 116/2009 "Mbi eksportin e mallrave kulturore"	Projektakti është detyrim i parashikuar në PKIE	JO	JO	JO
27	Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 3, e nenit 11	Ky projektakt do të përcaktojë masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në situata jonormale siç janë fatkeqësitë natyrore dhe konfliktet e armatosura.	JO	JO	JO	JO

28	Për përcaktimin e tarifave për shpërblim të arsyeshëm nga riprodhimi i veprave për përdorim privat ose për përdorim tjetër personal	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor, ligji nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to"	Ky projektakt rregullon përkufizimin e tarifës për shpërblim të arsyeshëm, përcaktimin e palëve të cilët do të jenë subjektet që do t'i nënshtrohen aplikimit të tarifës. Përcaktohen pajisjet dhe të gjitha mjetet e tjera që nevojiten për regjistrimin vizual dhe zanor, që bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal. Afatet e pagesës së kësaj tarife, dokumentacioni që importuesit dhe/ose prodhuesit vendas duhet të vendosin në dispozicion të Sporteli Unik për Administrimin e së Drejtës së Autori	JO	JO	JO	Ka impakt në ekonomi në masën 0.5 % të pajisjeve që prodhohen për herë të parë ose importohen në RSH
29	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to"	Projektligj	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Marrëveshja e Asociim –Stabilizimit në nenin 73, të saj "Të drejtat e pronësisë intelektuale", Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016–2020. Direktiva 2012/28/KE, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 tetor 2012, "Për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor",	Ky projektakt rregullon krijimin e një kuadri ligjor për mundësimin e digjitalizimit dhe të përhapjes së veprave dhe të materialeve të tjera që mbrohen nga e drejta e autorit ose të drejta të tjera të lidhura me të për të cilat nuk ka mbajtës të së drejtës së identifikuar ose për të cilat mbajtësi i së drejtës edhe kur identifikohet, nuk mund të gjendet - të ashtuquajturat vepra pa autor - përbën një masë themelore të planit digjital për Evropën. Synohet të zgjidhet problemi konkret i përcaktimit ligjor të statusit të veprës pa autor dhe të pasojave përkatëse në lidhje me përdoruesit dhe përdorimet e lejuara të veprave apo të fonogrameve që konsiderohen si vepra pa autor.	Ky akt është parashikuar në PKIE 2019-2021, kapitulli 7 "E Drejta e Pronësisë Intelektuale"	JO	JO	PO/Kulturor, Social, Financiar
30	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096, datë 21.3.1996, "Për kinematografinë", i ndryshuar.	Projektligj	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Grupet e interesit	Synon të nxisë veprimtarinë e kineasteve. Rregullimin e organeve kolegjiale vendimmarrëse, si dhe veprimtarinë e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit	JO	JO	JO	PO
31	"Për mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve këshillimore për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale"	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"	Ky projektakt përcakton mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve këshillimore për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë kulturore	JO	JO	JO	PO
32	Për deklarimin pasuri kulturore të qendrave historike, si dhe miratimi i planeve të administrimit të zonave të tyre.	projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"	Përcakton pasuri kulturore qendrat historike dhe përcakton rregullat për administrimin e tyre.	JO	JO	JO	JO
33	Për kushtet e posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike.	Projektvendim	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 3, e nenit 139	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në fushën e lejeve për hulumtime arkeologjike.	JO	JO	JO	JO

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2020

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017-2021 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	PVKM "Për kriteret, standardet dhe procedurat për akreditimin e: a) veprimtarive të trajnimit të vazhdueshëm; dhe b) të ofruesve të veprimtarive trajnimit".	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori II	Detyrim ligjor neni 43, pika 4, e ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".	Akreditimi i të gjitha subjekteve publike/jopublike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të huaja dhe vendase, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të licencuara për ofrimin e trajnimeve e të kualifikimeve. Aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror të akredituara për ofrimin e trajnimeve e të kualifikimeve.	Jo	Kapitulli 3.3 "Shëndetësia dhe kujdesi social". Mbulimi shëndetësor universal.	Jo	Jo nuk ka ndikime të mundshme ekonomike, financiare; Jo nuk ka ndikime sociale; Jo nuk parashikohet të ketë ndikime mjedisore.
2	PVKM "Për kriteret, standardet dhe procedurat e trajnimit të vazhdueshëm për profesionistet e shërbimeve të kujdesit shoqëror".	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori II	Detyrim ligjor neni 42, pika 1, e ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".	Përcaktimi i rregullave dhe procedurave për profesionistet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, për rritjen e kapaciteteve dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve shoqërore.	Jo	Kapitulli 3.3 "Shëndetësia dhe kujdesi social". Mbulimi shëndetësor universal.	Jo	Jo nuk ka ndikime të mundshme ekonomike, financiare; Jo nuk ka ndikime sociale; Jo nuk parashikohet të ketë ndikime mjedisore.
3	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 163/2014, "Për Urdhrin e Punonjësit Social në Republikën e Shqipërisë".	Projektligj	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori II	Me kërkesë të Komisionit të Përkohshëm të Urdhrit të Punonjësit Social.	Kërkohet të ndryshohen kriteret minimale të regjistrimit dhe licencimit të Punonjësve Socialë në Urdhrin e Punonjësve Sociale, në Republikën e Shqipërisë.	Jo	Kapitulli 3.3 "Shëndetësia dhe kujdesi social". Mbulimi shëndetësor universal.	Jo	Jo nuk ka ndikime të mundshme ekonomike, financiare; Jo nuk ka ndikime sociale; Jo nuk parashikohet të ketë ndikime mjedisore.
4	PVKM "Për përcaktimin kritereve të shërbimeve të kujdesit shoqëror që ofrohen kundrejt pagesës".	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori III	detyrim ligjor, në zbatim të paragrafit 2, të nenit 46 dhe të pikës 1, të nenit 51, të ligjit nr. 121, datë 21.11.2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".	Përcaktimin e tarifave që do të paguhen nga përfituesi i shërbimit të kujdesit shoqëror të cilat do të shkojnë për mbulimin e një pjese të shpenzimeve korente për njësitë e shërbimit në fjalë dhe të përcaktojë për pushtetin vendor mënyrën e financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror si pjesë e paketës fiskale dhe buxhetit vjetor të bashkisë. Garantimi i ngritjes, administrimit dhe mirëmbajtjes periodike të shërbimeve të kujdesit shoqëror të	Jo	Kapitulli 3.3 "Shëndetësia dhe kujdesi social". Mbulimi shëndetësor universal.	Jo	Jo nuk ka ndikime të mundshme ekonomike, financiare; Jo nuk ka ndikime sociale; Jo nuk parashikohet të ketë ndikime mjedisore.

						ofruara brenda territorit të bashkisë nëpërmjet buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore.				
5	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar.	Projektligj	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori III	Përshtatja e ligjit nr. 105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, me Direktivat e Bashkimit Evropian.	Ndryshimet kryesore që synohen të arrihen janë: Formati tip për recetën mjekësore; Përafrimi i rregullave për fletudhëzuesin me direktivat e BE-së; Kriteret për hapjen e farmacive të rrjetit të hapur farmaceutik; Tregtimi në distancë i barnave; Përgatesat galenike; Parafarmacitë; Reklamimi i barnave.	Po, kapitulli 28," Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik".	Kapitulli 3.3 "Shëndetësia dhe kujdesi social". Mbulimi shëndetësor universal.	Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2016–2020, Prioriteti Strategjik 2: Mbulimi Shëndetësor Universal për të gjithë, Objektivi 2.4.	Jo nuk ka ndikime të mundshme ekonomike, financiare; Jo nuk ka ndikime sociale; Jo nuk parashikohet të ketë ndikime mjedisore.
6	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8876, datë 4.4.2002, 'Për shëndetin riprodhues', të ndryshuar."	Projektligj	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori III	Përafrimi i legjislacionit me ndryshimet e fundit të teknologjisë dhe të të rejave në fushën e shëndetit riprodhues.	Ndryshimet synojnë përmirësimin e sistemit shëndetësor në shëndetin riprodhues.	Jo	Kapitulli 3.3 "Shëndetësia dhe kujdesi social". Mbulimi shëndetësor universal.	Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2016–2020, Prioriteti Strategjik 1: Investimi në shëndetin e njerëzve gjatë gjithë ciklit të jetës, Objektivi 1.1., 1.2, 1.3 dhe 1.5 dhe Prioriteti Strategjik 3: Fuqizimi i sistemit shëndetësor, duke vendosur në qendër të sistemit njerëzit, Objektivi 3.5.	Jo nuk ka ndikime të mundshme ekonomike, financiare; Jo nuk ka ndikime sociale; Jo nuk parashikohet të ketë ndikime mjedisore.
7	PVKM "Për përcaktimin e listës së barnave në rimbursim për vitin 2020".	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori II	Detyrim ligjor në mbështetje të pikës 3, nenit 37, të ligjit nr. 105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, dhe të pikave 2, germa "b", dhe 6 të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.	Ky projektvendim synon miratimin listën e barnave të rimbursueshme nga skema e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.	Jo	Kapitulli 3.3 "Shëndetësia dhe kujdesi social". Mbulimi shëndetësor universal.	Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2016–2020, Prioriteti Strategjik 2: Mbulimi Shëndetësor Universal për të gjithë, Objektivi 2.1, 2..2, 2.3, dhe 2.4.	Po ka ndikime financiare. Efekti është përllogaritur në buxhetin e vitit 2020 dhe do të përballohet nga FSDKSH-ja. Po ka ndikime pozitive sociale, sepse synohet ofrimi i mbulimit shëndetësor universal për të gjithë. Jo nuk parashikohet të ketë ndikime mjedisore.
8	PVKM "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020".	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori I	Detyrim ligjor në zbatim të nenit 10, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.	Ky projektvendim synon financimin e shërbimit spitalor nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.	Jo	Kapitulli 3.3 "Shëndetësia dhe kujdesi social". Mbulimi shëndetësor universal.	Jo	Po efekti financiar është përllogaritur në buxhetin e vitit 2020 dhe do të përballohet nga FSDKSH-ja dhe MSHMS-ja. Po ka ndikime pozitive sociale, sepse synohet ofrimi i mbulimit shëndetësor universal për të gjithë. Jo nuk parashikohet të ketë ndikime mjedisore.
9	PVKM Për miratimin e Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë	Katërmujori I	Në zbatim të ligjit nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor", të	Ky projektvendim synon miratimin e Rregullores "Për organizimin dhe	Jo	Kapitulli 3.3 "Shëndetësia dhe kujdesi social". Mbulimi	Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2016-2020,	Po ka efekte financiare pasi do të rritet grup-mosha e fëmijëve të

	Qendrës Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit, Rehabilitimit të Fëmijëve".		dhe Mbrojtjes Sociale		ndryshuar, dhe ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".	funksionimin e Qendrës Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit, Rehabilitimit të Fëmijëve" ku ndër të tjera do të ketë në fokus: përcaktimin e kritereve të shërbimit/ përcaktimin e target grupit që i ofron shërbim të drejtpërdrejtë ose indirekt, si edhe kriteret e pranimit dhe të daljes nga shërbimi kur është e aplikueshme. trajtimit dhe monitorimit të indikatorëve të cilësisë për fëmijët.		shëndetësor universal.	Prioriteti Strategjik 1: Investimi në shëndetin e njerëzve gjatë gjithë ciklit të jetës, Objektivi 1.5 dhe Prioriteti Strategjik 3: Fuqizimi i sistemit shëndetësor, duke vendosur në qendër të sistemit njerëzit, Objektivi 3.5.	strehuar në qendër, ky efekt do të përballohet nga MSHMS-ja. Po ka ndikime sociale pozitive, sepse do të kenë mundësinë të strehohen në qendër me shumë fëmijë që janë në nevojë për trajtim dhe rehabilitim. Jo nuk ka ndikime mjedisore.
10	PVKM "Për mënyrën dhe formatin e mbledhjes, raportimit dhe shkëmbimit të të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor".	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori I	Në zbatim të nenit 30, paragrafi 3, të ligjit nr. 27/2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009, 'Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar ".	Projektvendimi synon përcaktimin e mënyrës dhe formatit për mbledhjen, raportimin dhe shkëmbimin e të dhënave shëndetësore në format elektronik ose në letër, për ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, publike ose jopublike.	Jo	Kapitulli 3.3 "Shëndetësia dhe kujdesi social". Mbulimi shëndetësor universal.	Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2016–2020, Prioriteti Strategjik 3: Fuqizimi i Sistemit shëndetësor, duke vendosur në qendër të sistemit njerëzit, Objektivi 3.2 dhe Prioriteti Strategjik 4: Përmirësimi i qeverisjes dhe bashkëpunimit ndërsektorial për shëndetin, Objektivi 4.1, 4.2 dhe 4.5.	Jo nuk ka ndikime të mundshme ekonomike, financiare; Jo nuk ka ndikime sociale; Jo nuk parashikohet të ketë ndikime mjedisore.
11	PVKM "Për mënyrën e administrimit të sistemit elektronik të integruar të informacionit shëndetësor".	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori I	Në zbatim të nenit 30, paragrafi 1, të ligjit nr. 27/2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009, 'Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar ".	Ky projektvendim do të përcaktojë mënyrën e administrimit të regjistrave të caktuar dhe dosjeve vetjake shëndetësore të individit, bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare të informacionit shëndetësor.	Jo	Kapitulli 3.3 "Shëndetësia dhe kujdesi social". Mbulimi shëndetësor universal.	Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2016–2020, Prioriteti Strategjik 4: Përmirësimi i qeverisjes dhe bashkëpunimit ndërsektorial për shëndetin, Objektivi 4.5.	Po ka ndikime financiare. Efekti lidhet me përshtatshmërinë e sistemeve për të gjithë ofruesit e kujdesit shëndetësor është brenda buxhetit të MSHMS-së. Jo nuk parashikohet të ketë ndikime sociale ose mjedisore.
12	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012, "Për shëndetin mendor", të ndryshuar.	Projektligj	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori III	Rekomandimet e CPT-së për ndryshime të ligjit të shëndetit mendor	Ndryshimi do të lidhet me masat për mjekimin e pavullnetshëm, dhe kufizimin fizik.	Jo	Kapitulli 3.3 "Shëndetësia dhe kujdesi social". Mbulimi shëndetësor universal.	Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2016–2020, Prioriteti Strategjik 1: Investimi në shëndetin e njerëzve gjatë gjithë ciklit të jetës, Objektivi 1.5 dhe Prioriteti Strategjik 3: Fuqizimi i sistemit shëndetësor, duke vendosur në qendër të sistemit njerëzit, Objektivi 3.5.	Jo nuk ka ndikime të mundshme ekonomike, financiare; Jo nuk ka ndikime sociale; Jo nuk parashikohet të ketë ndikime mjedisore.
13	Projektvendim për "Dekomisionimin e qendrave që përdorin burime të rrezatimit jonizues",	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori III	Në zbatim të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese"	Qëllimi kryesor është dekompensimi i qendrave që përdorin burime të rrezatimit jonizues	Po, kapitulli 15 "Energjia"	Kapitulli 3.3 Shëndetësia dhe Kujdesi social. Mbulimi shëndetësor universal.	Jo	Nuk parashikohet të ketë ndikime ekonomike, sociale ose mjedisore

14	Projektvendim për "Për miratimin e paketës së Programit të Depistimit të Kancerit të Gjirit në Shqipëri	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori II	Ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, "Për shëndetin publik"	Programi kombëtar i depistimit të kancerit të gjirit është paketë shërbimesh ndihmëse në shëndetin publik me qëllim identifikimin e hershëm të kancerit të gjirit dhe uljen e vdekshmërisë nga kanceri i gjirit. Paketa e shërbimeve përfshin ekzaminimet sistematike nëpërmjet palpimit të gjirit dhe mamografisë, ekzaminimet e mëtejshme diagnostikuese, dhe trajtimin për të gjitha gratë që diagnostikohen me kancer.	Jo	Kapitulli 3.3 Shëndetësia dhe kujdesi social. Mbulimi shëndetësor universal.	jo	Po efekti financiar është përllogaritur në buxhetin e vitit 2020 dhe do të përballohet nga MSHMS-ja. Po ka ndikime pozitive sociale, sepse synohet ofrimi i mbulimit shëndetësor falas për target grupin e caktuar

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2020

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017–2021 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Amendim i ligjit 8672, datë 26.10.2000, "Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të Drejtën e Publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit".	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Propozimi i këtij akti ka si qëllim përfshirjen e procesit të informimit dhe tërheqjes së publikut në vendimmarrje për organizmat e modifikuar gjenetikisht.	Përcakton procedurat për informim të hershëm dhe efektiv dhe pjesëmarrje publike para marrjes së vendimeve nëse duhet të lejohet nxjerrja vullnetarisht në mjedis dhe vendosja në treg e organizmave të modifikuar gjenetikisht.	Jo	Po. Pika 2.3, siguria ushqimore.	Po, lidhet me Strategjinë e Mjedisit dhe Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014–2020.	Po ka ndikim social pasi ndihmon në rritjen e besimit të qytetarëve në vendimmarrjen që ndërmarrin institucionet shtetërore.
2	"Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat, masat dhe kriteret e përdorimit të tyre".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Përcaktimi i vlerave për masat e ardhurave nga tarifat, si dhe përcaktimi i masës dhe kritereve për përdorimin e tyre.	Përcaktimi i tarifave monetare për veprimtaritë e lejuara në zonat e mbrojtura.	Jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me Dokumentin e Politikave Pyjore në Shqipëri 2019–2030.	Jo projektvendimi nuk ka ndikim.
3	"Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve spitalore".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Akti propozohet me qëllim ofrimin e udhëzimeve për prodhuesit e mbetjeve (gjeneruesit) dhe grumbulluesit e tyre për t'i ndihmuar ata të veprojnë në përputhje me kërkesat ligjore, të rrisë dhe mbrojë sigurinë dhe shëndetin publik, të sigurojë një mjedis më të sigurt pune, të minimizojë gjenerimin e	Objektivi i këtij akti lidhet me përcaktimin e kërkesave që synojnë të disiplinojnë menaxhimin e mbetjeve spitalore. Në akt përcaktohen kërkesat lidhur me grumbullimin, ambalazhimin, etiketimin, ruajtjen e përkohshme, trajtimin dhe	jo	Po. Pika 2,4 "Mjedisi", f. 12.	Po, lidhet me Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Mbetjeve".	Po, mjedisore

					mbetjeve dhe ndikimin mjedisor të trajtimit dhe asgjësimit të tyre.	asgjësimin në mënyrë të kontrolluar të mbetjeve spitalore.				
4	"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	1. Për të arritur përputhshmërinë e plotë më direktivat përkatëse evropiane; 2. Për të plotësuar detyrimet e vendit në nivel ndërkombëtar.	Ky projektakt synon: 1. ngritjen e një sistemi kombëtar, bashkëkohor dhe të integruar të VNM-së për të arritur në një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis nga projekte të propozuara, sipas madhësisë, natyrës apo vendosjes së tyre. 2. Përcaktimi në mënyrë të qartë dhe të plotë të procedurës së vlerësimit që ndiqet nga personat fizikë dhe juridikë në rolin e zhvilluesit të projektit dhe nga administrata dhe institucionet qendrore e vendore në rolin e organeve vendimmarrëse.	Po, kapitulli 27 "Mjedisi".	Po. Pika 2,4 "Mjedisi", f. 12.		Po projektvendimi ka ndikim social dhe mjedisor. Nuk ka ndikim financiar.
5	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar.	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Amendimi i ligjit ekzistues vjen si nevojë e detyrimeve që lindin nga zbatimi I Protokollit të Nagoya-s për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre.	Krijimi i një kuadri ligjor kombëtar që mundëson plotësimin e detyrimeve të Protokollit të Nagoyas.	Po, kapitulli 27 "Mjedisi".	Po, pika 2.1, "Mjedisi", f. 12.	Po, projektakti lidhet me Dokumentin e Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.	Po projektvendimi ka ndikim social dhe mjedisor. Nuk ka ndikim financiar.
6	"Mbi rregullat e nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes nga asbesti".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Ky projektvendim do të përcaktojë rregullat e nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti.	Të përafrojë legjislacionin kombëtar me atë evropian, lidhur me mbrojtjen e mjedisit nga asbesti.	Po, kapitulli 27, mjedisi dhe kapitulli 1, lëvizja e lire e mallrave.	Po Pika 2.4 "Mjedisi"	Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2015–2020 Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve 2010–2023	Ky projektvendim parashikohet të ketë ndikim mjedisore dhe social.
7	"Mbi rregullat për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve kombëtare për pakësimin e shkarkimeve në ajër".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	ky projektvendim synon: 1. të përcaktojë rregullat për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve kombëtare për pakësimin e shkarkimeve në ajër, si dokumenti kryesor i Republikës së Shqipërisë për të siguruar që angazhimet për pakësimin e shkarkimeve në ajër për periudhën 2020–2030 të jenë	Të përafrojë legjislacionin kombëtar me atë evropian, lidhur me programet kombëtare të shkarkimeve në ajër.	Po. Kap. 27, "Mjedisi".	Po. Pika 2.4, "Mjedisi", f. 12	Po, me strategjinë kombëtare të cilësisë së ajrit në mjedis.	Ky projektvendim parashikohet të ketë ndikim mjedisore dhe social.

					përmbushur.					
8	"Për përcaktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në zonat e mbrojtura mjedisore, mënyrës së vlerësimit, mbledhjes dhe administrimit të saj".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Propozimi I këtij projektakti ka si qëllim vendosja e vlerës së dëmit për të gjitha subjektet të cilat dëmtojnë dhe rrezikojnë me anë të veprimeve apo mosveprimeve të tyre në një zonë të mbrojtur.	Rregullimin e vlerësimit e dëmit të shkaktuar në një zonë të mbrojtur nga një person fizik a juridik, publik apo privat vendas ose i huaj, i cili do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar duke përballuar kostot e riparimit të dëmit, të rehabilitimit dhe të kthimit në gjendjen e mëparshme të zonës së mbrojtur.	Jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet Dokumentin e Politikave Pyjore në Shqipëri 2019-2030.	Nuk ka ndikim financiar. Ka ndikim social dhe mjedisor, pasi ka si qëllim mbrojtjen e mjedisit.
9	"Për kriteret e rregullat dhe për miratimin e lejes për mbledhjen, aksesin dhe përdorimin e materialeve a të mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura mjedisore".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Projektakti propozohet me qëllim mbledhjen dhe përdorimin e materialeve biologjike, si dhe mostrave në zonën e mbrojtur.	Rregullimin e veprimtarisë së mbledhjes, përdorimit të materialeve dhe mostrave, si dhe aksesit në mjediset e zonave të mbrojtura, nga personat fizikë, juridikë dhe të huaj.	Jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet Dokumentin e Politikave Pyjore në Shqipëri 2019–2030.	Jo projektvendimi nuk ka ndikim.
10	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.967, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave 'Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të menaxhimit të integruar të mbetjeve'".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Ndryshimi i aktit ekzistues ka si qëllim përshtatjen e emërtesës së institucioneve anëtare të Komitetit të Menaxhimit të Mbetjeve, në funksion të organizimit të ri të ministrive sipas fushave të përgjegjësisë që ato kanë, si dhe parashikimin e ngritjes së dy strukturave mbështetëse të këtij Komiteti gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.	1.Përshtatjen e emërtesës së institucioneve anëtare të Komitetit të Menaxhimit të Mbetjeve, në funksion të organizimit të ri të ministrive sipas fushave të përgjegjësisë që ato kanë. 2.Parashikimin e ngritjes së dy strukturave mbështetëse të këtij Komiteti gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.	Po (Kapitulli 27)	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me SKZHI-në dhe me Dokumentin e Politikave Strategjike të Biodiversitetit.	Projektvendimi ka ndikim ekonomik dhe financiar pasi lidhet me përcaktimin e tarifave që duhet të paguajnë personat fizikë dhe juridikë për përdorimin e llojeve të faunës së egër.
11	"Për disa ndryshime në VKM-në nr. 692, datë 5.10.2016, "Për miratimin e rregullores "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Ky akt ka si qëllim të thjeshtojë procedurën dhe të reduktojë dokumentacionin e aplikimit.	Lehtëson procesin për pajisjen me certifikatën e udhërrëfyesit turistik në tërësi	jo		Strategjia Kombëtare për zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023	jo
12	"Për disa ndryshime në VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish komunave/bashkive". - Faza e parë	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Të mundësojë finalizimin e procesit të regjistrimit të pasurive pyje dhe kullota në pronësi të bashkive respektive, si dhe administrimin e qëndrueshëm të këtij fondi nga ana e bashkive në zbatim të decentralizimit të kompetencave, nga pushteti qendror tek pushteti vendor	nenit 18, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", të ndryshuar dhe të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së	jo	jo		jo

						Shqipërisë"				
13	Projektligj "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin DOHA të Protokollit të Kiotos.	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Qëllimi i propozimit të këtij projektakti është vjen si nevojë e zbatimit të detyrimeve ndërkombëtare. Shqipëria e ka ratifikuar Marrëveshjen e Parisit, dhe është pozicionuar në mbështetje të këtij amendamenti dhe ratifikimi i tij është formalitet. Nëpërmjet ratifikimit të amendamentit të Dohas, Shqipëria tregohet qëndrueshmëri në vendimet e marra më parë: ratifikimin e protokollit të Kiotos dhe Marrëveshjes së Parisit.	1. Angazhime të reja për Palët në aneksin I, të Protokollit të Kiotos të cilët ranë dakord për një periudhë të dytë angazhimi nga 1 janari 2013 deri më 31 dhjetor 2020; 2. Një listë e rishikuar e gazrave serrë (GHG) që do të raportohen nga Palët në periudhën e dytë të angazhimit.	Jo		Dokumenti Strategjik i ndryshimeve klimatike, Strategjinë Ndërsektoriale të Mjedisit	Nuk ka ndikim Nuk sjell detyrime apo kosto mbi Shqipërinë për reduktimin e gazeve serrë, pasi ajo nuk bën pjesë në aneksin I, të Konventës së Ndryshimeve Klimatike dhe as në aneksin B, të Protokollit të Kiotos ku bëjnë pjesë vendet me detyrime për reduktim të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.
14	Për disa ndryshime në ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Përmirësimi dhe rishikimi i kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve në kuadër të vendosjes së objektivave të dokumentit të Politikave të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve	Projektligji është konceptuar si një ligj integral për menaxhimin e mbetjeve, duke synuar çështjet e menaxhimit të mbetjeve nga qeset plastike,	Jo	Po, Pika 2.4, Mjedisi, f. 12	Po, Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Mbetjeve	Po
15	"Për miratimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit, për Menaxhimin e 2020–2035", e rishikuar.	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Ky dokument është i nevojshëm të rishikohet pasi të gjithë objektivat e vendosur në strategjinë ekzistuese nuk u arritën për shkak të pamjaftueshmërisë financiare dhe mungesës së kapaciteteve në nivel qendror dhe vendor. Ky akt del në bazë dhe për zbatim të nenit 21, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.	Dokumenti do të mbulojë periudhën 2020-2035 dhe ka si qëllim kryesor të rishikojë aftësitë e vendit për të përmbushur detyrimet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian që rrjedhin nga *acquis communautaire* kapitulli 27 "Për mjedisin", duke paraqitur një drejtim strategjik efikas dhe të përballueshëm për zbatuesit e politikave të menaxhimit të mjedisit në nivel qendror dhe vendor.	Jo	Po. Kapitulli 27 "Mjedisi". P/VKM "Për rishikimin e VKM-së nr. 175, datë 19.1.2011, 'Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve'". Akti ka qenë i parashikuar për t'u miratuar gjatë tremujorit IV të vitit 2017.	Po. Pika 2.4 "Mjedisi", f. 12	Projektakti ka ndikim ekonomik, financiar, social dhe mjedisor
16	"Për masën e fondit e veçantë për zonat e mbrojtura mjedisore, për burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Krijimi i një fondi të veçantë për ZM-të, nga fonde të siguruara nga të ardhurat dhe nga kontributet e donatorëve - Në bazë dhe për zbatim të nenit 59 pika 2, e ligjit 81/2017, "Për zonat e mbrojtura".	Administrimin dhe përdorimin e të ardhurave në zonat e mbrojtura nëpërmjet fondit të veçantë, me qëllim përballimin e emergjencave, rehabilitimin dhe zhvillimin e zonat e mbrojtura.	Jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me SKZHI-në dhe me Dokumentin e Politikave Strategjike të Biodiversitetit.	Projektvendimi ka ndikim, ekonomik, financiar dhe social pasi administrimi dhe përdorimi i të ardhurave në zonat e mbrojtura nëpërmjet fondit të veçantë, synon përballimin e emergjencave, rehabilitimin dhe zhvillimin e ZM-ve.
17	"Për disa ndryshime në VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Të mundësojë finalizimin e procesit të regjistrimit të pasurive pyje dhe kullota në pronësi të bashkive respektive, si dhe administrimin e qëndrueshëm të këtij fondi nga ana	Nenit 18, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të	jo	jo		

	të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive".				e bashkive në zbatim të decentralizimit të kompetencave, nga pushteti qendror te pushteti vendor.	ndryshuar dhe të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".				
18	"Për përcaktimin e masës së tarifës së përdorimit të faunës së egër, llojit dhe mënyrat e pagimit të saj".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Të plotësojë me akte nënligjore, dhe të rrisë zbatueshmërinë e ligjit "Për mbrojtjen e faunës së egër", nr. 10006, datë 23.10.2008.	Vendosja e tarifave të përdorimit të llojeve të faunës së egër nga persona fizikë e juridikë. Përcaktimi i kategorive të përdorimit dhe masave respektive të tarifave për çdo kategori dhe i mënyrave të pagesës së saj.	Jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me Dokumentin e Politikave Pyjore në Shqipëri 2019–2030.	Jo projektvendimi nuk ka ndikim,
19	"Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve shtazore, që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Ky akt ka si qëllim të përcaktojë rregullat për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu, në mënyrë që të parandalojë dhe minimizojë rreziqet ndaj shëndetit të njeriut dhe kafshëve që vijnë nga këto produkte dhe në veçanti të mbrojë sigurinë e ushqimit dhe zinxhirit ushqimor në vend.	Ky vendim do të zbatohet për nënproduktet kafshëve dhe produktet e përfituara prej tyre të cilat janë përjashtuar nga konsumi njerëzor.		Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Mbetjeve.	Po, ka ndikim mjedisor, pasi krijohet një mjedis më pak I ndotur nga nënproduktet shtazore.
20	"Mbi normat e lundrimit ".	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Ku akt ka si qëllim lehtësimin e procedurave të lundrimit të anijeve turistike/jahteve, përgjatë sezonit turistik në ujërat territoriale shqiptare, si dhe për përcaktimin e moleve turistike përgjatë vijës bregdetare shqiptare, e të procedurave lehtësuese për jahtet turistike në portet tona".	1. Ky projektakt synon të adresojë problematikat në procedurat e lundrimit të mjeteve turistike, si dhe mungesa e porteve turistike të miratuara. 2. Nxitjen dhe zhvillimin e turizmit detar. 3.Siguron kushte lehtësuese për lëvizjen e mjeteve lundruese turistike.	Po	Po. Pika 2.6, Infrastrukturë-transporti detar-Monitorimi i ujërave.	Po, lidhet me Strategjinë e Zhvillimit të turizmit.	Projektligji ka ndikim mjedisor dhe financiar. Nuk ka ndikim social.
21	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 641, datë 1.10.2014 'Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Ndryshimi i aktit ekzistues lehtëson procedurën për aplikuesit dhe përmirëson cilësinë e shërbimit të ofruar.	Projektakti synon lehtësimin e procedurave për eksportin e mbetjeve.	Po	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Lidhet me Strategjinë Sektoriale të Mbetjeve.	Po ka ndikim mjedisor, pasi krijohet një mjedis me pak i ndotur nga plastika.
22	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 371 datë 11.6.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Projektakti propozohet në kuadër të reformës së derregullimit.	Lehtësimin e procedurave për aplikuesit, në kuadër të reformës së derregullimit.	Jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Lidhet me Strategjinë Sektoriale të Mbetjeve	Ka ndikim mjedisor

	mbetjeve të rrezikshme ".									
23	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 229, datë 23.4.2014, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Projektakti propozohet në kuadër të reformës së derregullimit.	Lehtësimin e procedurave për aplikuesit, në kuadër të reformës së derregullimit.	Jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Lidhet me Strategjinë Sektoriale të Mbetjeve	Ka ndikim mjedisor
24	"Për rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve.	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Të rregullojë procesin e certifikimit të specialistëve të diplomuar në fushën e pyjeve, me synim pajisjen e subjekteve të interesuar me "drejtues teknikë".	Rregullon procedurat e pajisjes me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve	Jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Lidhet me Strategjinë Sektoriale të Mbetjeve.	Jo nuk ka ndikim të asnjë lloj natyre.
25	"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 99, datë 18.2.2005, "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Të përditësojë katalogun e mbetjeve në përputhje me katalogun evropian të mbetjeve.	Shtimin e kodeve të reja në përputhje me kodet e përcaktuara në katalogun evropian të mbetjeve	Jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Lidhet me Strategjinë Sektoriale të Mbetjeve.	Jo projektvendimi nuk ka ndikim.
26	"Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Ky akt ka si qëllim të standardizojë dhe rregullojë procedurat për paraqitjen e kërkesës, dokumentacionin e nevojshëm për rastet e heqjes dhe/ose shtimit të fondit pyjor publik.	Rregullon procesin dhe procedurat në tërësi për subjektet që ushtrojnë aktivitet të ligjshëm mbi fondin pyjor	Jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Lidhet me Strategjinë Sektoriale të Mbetjeve.	Projektvendimi nuk ka ndikim ekonomik dhe financiar pasi lidhet me mënyrën e funksionimit të komitetit, me qëllim bashkërendimin e detyrave të ministrive për menaxhim të integruar mjedisor të mbetjeve,
27	"Për rregullat e trajtimit, shfrytëzimit, shitjes, eksportit (rastet e lejuara), importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimi i rrugëve autopyjore, përdorimi dhe standardet teknike të tyre".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Ky akt ka si qëllim të rregullojë dhe standardizojë procedurat e shfrytëzimit të fondit pyjor, trajtimit të tij dhe lëvizjen e mallrave me origjinë nga fondit jashtë territorit të RSH-së.	Vendos rregulla dhe kritere për shfrytëzimin, trajtimin dhe lëvizjen e materialit drusor me origjinë nga fondi pyjor, jashtë territorit të RSH-së.	Jo	Po. Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Lidhet me Strategjinë Sektoriale të Mbetjeve.	Po ka ndikim mjedisor, pasi krijohet një mjedis me pak i ndotur nga nënproduktet shtazore.

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2020										
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë										
Nr.	**Titulli i projektaktit**	**Lloji i projektaktit**	**Ministri propozues**	**Katërmujori**	**Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit**	**Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti**	**A është parashikuar projektakti në PKIE?** **Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës**	**Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017 2021** **Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam**	**Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale** **Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë**	**Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore** **Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse**
1	Amendimi i ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar	Projektligj	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Detyrim në kuadër të Traktatit për Krijimin e Komunitetit të Energjisë, për implementimin e Rregullores (EU) 2017/1938 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 25 tetorit 2017, në lidhje me garantimin e sigurisë së furnizimit me gaz dhe zëvendësimin e Rregullores (EU) Nr. 994/2010	Do të përditësojë dispozitat përkatëse të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, për sa ka të bëjë me garantimin e sigurisë së furnizimit me gaz.	Po	2.2 Energjia dhe burimet natyrore "Politika e Qeverisë në këtë mandat të ri do të vazhdojë të orientohet drejt rritjes të sigurisë së furnizimit me energji të konsumatorëve, duke pasur për objektiv mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet rritjes së punësimit dhe promovimit të energjisë së rinovueshme dhe eficiencës së energjisë, duke stimuluar konkurrencën në treg, duke siguruar stabilitet dhe minimizuar kostot për konsumatorët shqiptarë, si dhe duke garantuar mbrojtjen e mjedisit."	VKM-ja nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030", lidhur me domosdoshmërinë e rritjes së sigurisë së furnizimit me burim, e energjetike	JO
2	"Për miratimin e kontratës me ndarje prodhimi e ndryshuar dhe e riformuluar, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, blloku 2–3, ndërmjet Ministrisë së infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V."	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Përshtatja me "Modeli i Ri" i KNP-ve pasi do të shërbejë si bazë për negociatat e ardhshme ndërmjet MIE-s dhe kompanive të tjera të interesuara për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbur të territorin e Republikës së Shqipërisë.	Përveç çështje të karakterit teknik një tregues i matshëm dhe shumë sinjifikativ i këtij modeli lidhet me vendosjen e tavanit në përdorimit e të ardhurave për mbulimin e kostove hidrokarbure në nivelin e 90%. Kjo e shprehur me terma më praktikë ka të bëjë me marrjen e fitimit nga shteti shqiptar që në barelën e parë të naftës bruto që do të prodhohet.	jo	**2.2 Energjia dhe burimet natyrore/ Hidrokarburet - Nafta dhe gazi** Në operimin e kërkim–prodhimit të naftës do të synohet që: (a) gjithë vendburimet naftëmbajtëse në tokë dhe det të jenë objekt i kontraktimit nga investitorë seriozë; (b) të kemi një portofol investimesh 4-vjeçar deri në 110 miliardë lekë; (c) të promovohet tek operatorët modeli i ri ekonomik i kontratave; (d) të rriten kapacitetet transportuese;	VKM-ja nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030" *Si akt nënligjor i parashikuar të dalë pas miratimit të p/ligjit Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport"*	po
3	Projekt-VKM "Për miratimin e Planit Kombëtar për zhvillimin e	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Përafrim me legjislacionin përkatës të BE-së dhe zhvillimi i *broadband*-it konsiderohet një investim i rëndësishëm që do të	1. Perspektivën e *broadband* në Shqipëri. 2. Krijimin e aksesit të gjithanshëm të internetit ndaj të gjitha grupeve të popullsisë, sektorin publik dhe privat.	Po, kapitulli 10 "Shoqëria e informacionit		Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015–2020	po

	Broadband-it"				krijojë vende pune direkte dhe indirekte dhe do të hapë mundësi të reja për ekonomitë lokale, përditësim i Planit ekzistues, afati i të cilit përfundon më 2020.		dhe medias"			
4	Projekt-VKM për miratimin e Planit të ri Kombëtar të Frekuencave	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Përafrim me legjislacionin përkatës të BE-së dhe reflektim i ndryshimeve që do të dalin nga Konferenca Botërore e Telekomunikacionit (WRC), m.q.s ky plan është i bazuar te Radio Rregulloret e ITU dhe publikimet e CEPT.	Ndarjen e brezave të frekuencave sipas përcaktimeve të përbashkëta evropiane dhe në Shqipëri. Masa harmonizuese me përdorimet kryesore të spektrit të frekuencave në Evropë. Përcaktimet e frekuencave në Shqipëri si për qëllime qeveritare, ashtu edhe për qëllime civile	Po, kapitulli 10 "Shoqëria e informacionit dhe medias"	Jo	JO	Jo
5	Projekt-VKM për miratimin e disa ndryshimeve në VKM-në nr. 599, datë 23.7.2010, për pagesat që kryhen në AKEP	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Plotësim i rregullimeve ekzistuese si nevojë e zhvillimeve në treg;	Propozim i AKEP-it për të plotësuar VKM-në ekzistuese me pagesa për shërbime të reja radiokomunikimi	jo nuk ka lidhje	jo	jo	jo
6	Projekt-VKM për miratimin e planit të shpenzimeve të AKEP-it për 2019	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Akt nënligjor i përvitshëm parashikuar në ligjin nr. 9918/2008	Përmbushja e detyrave funksionale të AKEP-it - sipas nenit 7 dhe 8, të ligjit për komunikimet elektronike; bazohet në propozimin e AKEP-it për kostot administrative të vitit 2019	jo nuk ka lidhje	jo	jo	Jo
7	Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave" që transpozon plotësisht direktivën 2010/31/EU "Mbi performancën e energjisë në ndërtesa (EPBD)";	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	1- I jep fuqi zbatuese ligjit nr. 116/2015, "Mbi performancën e energjisë në ndërtesa" . 2- Adreson rekomandimet e progres raportit 2018 të BE-së dhe të Nënkomitetit të BE-së në Shqipëri për Energjinë mbi hartimin e legjislacionit sekondar në fushën e eficiencës së energjisë.	Projektvendimi përcakton kërkesat minimale për performancën e energjisë së ndërtesave, të elementeve të ndërtesave dhe sistemeve teknike të ndërtesës, me qëllim që të arrihen nivelet e konsumit energjetik optimal të ndërtesave dhe elementeve të tyre;	Kapitulli 15	2.2 Energjia dhe burimet natyrore/ eficienca e energjisë	Strategjia e Energjisë 2018–2030	jo
8	Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Mbi metodologjinë për llogaritjen e niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave, njësive	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	1- I jep fuqi zbatuese ligjit nr. 116/2015, "Mbi performancën e energjisë në ndërtesa". 2- Adreson rekomandimet e progres raportit 2018 të BE-së dhe të Nënkomitetit të BE-së në Shqipëri për Energjinë mbi hartimin e legjislacionit sekondar	Projektvendimi synon të përcaktojë kuadrin e metodologjisë krahasuese për t'u përdorur për llogaritjen e niveleve optimale të kostos së kërkesave minimale të performancës së energjisë për ndërtesat dhe elementet e ndërtesave të reja dhe ekzistuese.	Kapitulli 15	2.2 Energjia dhe burimet natyrore/ eficienca e energjisë	Strategjia e Energjisë 2018–2030	jo

	dhe elementeve të ndërtesave"				në fushën e eficiencës së energjisë.					
9	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 124/2015, datë 12.11.2015, "Për eficiencën e energjisë", të ndryshuar.	Projektligj	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Adreson rekomandimet e progresraportit 2018 të BE-së dhe të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë për transpozimin e plote të Direktivës së Eficiencës së Energjisë 2012/27/BE brenda 15 tetorit 2017.	Projektligji do të mbulojë elementë të cilët aktualisht mungojnë në ligjin ekzistues për eficiencën e energjisë, duke përfshirë nenin 4 (Strategjia e rinovimit të ndërtesave), nenin 7 (Skemat detyruese për eficiencën e energjisë dhe alternativat), nenin 14 (Promovimi i eficiencës së energjisë në ngrohje dhe ftohje), nenin 15 (Transformimi, transmetimi dhe shpërndarja) dhe nenin 24 (Raportimi).	Kapitulli 15	2.2 Energjia dhe burimet natyrore/ eficienca e energjisë	Strategjia e Energjisë 2018–2030	jo
10	Projektvendim "Për miratimin e Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes së Performancës së Energjisë në ndërtesa"	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	1- I jep fuqi zbatuese ligjit nr.116/2015, "Mbi performancën e energjisë në ndërtesa" 2- Adreson rekomandimet e progres raportit 2018 të BE-së dhe të Nënkomitetit Transporti, Mjedisi, Energjia dhe Zhvillimi Rajonal mbi hartimin e legjislacionit sekondar në fushën e eficiencës së energjisë	Projektvendimi synon të krijojë Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së energjisë së ndërtesave, e cila do të përdoret për llogaritjen e nivelit të konsumit të energjisë në përputhje me kërkesat e performancës së energjisë së ndërtesave, njësive dhe elementeve të ndërtesave, me qëllim vlerësimin dhe plotësimin e certifikatave të performancës së energjisë. Ajo duhet të marrë në konsideratë dhe të përshtatet me legjislacionin në fuqi për ndërtesat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian	Kapitulli 15	2.2 Energjia dhe burimet natyrore/ eficienca e energjisë	Strategjia e Energjisë 2018–2030	jo
11	Projektvendim "Për Kriteret dhe procedurat për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë" të ndërtesave"	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	1-I jep fuqi zbatuese ligjit nr.116/2016, "Mbi performancën e energjisë në ndërtesa" 2- Adreson rekomandimet e progres raportit 2018 të BE-së dhe të Nënkomitetit Transporti, Mjedisi, Energjia dhe Zhvillimi Rajonal mbi hartimin e legjislacionit sekondar në fushën e eficiencës së energjisë	Projektvendimi synon të rregullojë procedurat dhe kriteret për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë.	Kapitulli 15	2.2 Energjia dhe burimet natyrore/ eficienca e energjisë	Strategjia e Energjisë 2018–2030	jo
12	Projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"	Projektligj	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Saktësim i çështjeve të nevojshme për t'u adresuar nga zbatimi në praktikë i ligjit	Saktësime procedurale	jo	JO	jo	jo
13	Projektvendimi "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 741, datë 9.9.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Saktësim i çështjeve të nevojshme për t'u adresuar nga zbatimi në praktikë i ligjit	Projektvendimi propozohet me qëllim rregullimin e procedurës për paraqitjen e projektit të rehabilitimit të mjedisit dhe llogaritjen e garancisë së investimit, për lejet minerare të dhëna sipas ligjit të vjetër nr. 7796, datë 17.2.2004, "Ligji minerar i Shqipërisë", si dhe vlerësimin e garancive mjedisore të përgjithshme e vjetore për këto leje. Gjithashtu qëllim kryesor i këtij projektvendimi është vendosja e një lehtësie për subjektet minerare që kanë	jo	JO		

	miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare[nu]					leje minerare zbulimi.				
14	Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut në Lidhje me Shërbimet Ajrore	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Kjo marrëveshje propozohet nga pala britanike në kuadër të procesit të daljes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian	Miratimi, në parim, i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar së Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut në lidhje me shërbimet ajrore, i hap rrugën nënshkrimit të një marrëveshjeje të re me palën britanike, e cila synon rritjen e bashkëpunimit dypalësh në fushën e transportit ajror.	JO	JO	JO	JO
15	Projekt-VKM, "Mbi udhëzimet e Bashkimit Evropian për Rjetin Transevropian TEN-T".	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Ky projektvendim ka si qëllim miratimin e Rregullores "Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit transevropian të transportit", përafruar plotësisht me Rregulloren (BE) nr. 1315/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 dhjetor 2013, "Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit trans-Evropian të transportit", të ndryshuar.	Përcakton udhëzimet për zhvillimin e rrjetit trans-Evropian të transportit, që përfshin një strukturë me dy nivele që përmban një rrjet të gjithëpërfshirës dhe një rrjet kryesor, ku ky i fundit përcaktohet në bazë të rrjetit të gjithëpërfshirës. Do të ndikojë në lidhjen më të shpejtë me vendet fqinje, përmirësimin e standardeve të ndërtimit të infrastrukturës rrugore, hekurudhore, ajrore dhe detare, qarkullimit, uljen e kohës së udhëtimit etj.	PO	PO	PO	JO
16	Projektligj për Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore	Projektligj	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Detyrim ligjor i BE-së	Garantimi dhe përmirësimi i sigurisë, parandalimi i akteve që kërcënojnë sigurinë në sektorin hekurudhor në Republikën e Shqipërisë, në përmbushje të detyrimeve të vendosura nga aktet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.	PO Projektligj për Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore	PO	PO	JO
17	Projektligj për Autoritetin Rregullator Hekurudhor	Projektligj	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Detyrim ligjor i BE-së	Rregullimi i ekuilibrave financiare të sipërmarrjeve hekurudhore, mbikëqyrjen e kontratave të shërbimit publik për garantimin e hapjes dhe rregullimit të tregut hekurudhor.	PO Projektligj për Autoritetin Rregullator Hekurudhor	PO	PO	Po, ka ndikim në buxhetin e shtetit sepse është institucion i ri.
18	Projektligj për Autoritetin Kombëtar të investigimit të	Projektligj	Ministri i Infrastrukturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor i BE-së	Parandalimi i aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore dhe sigurimi i një transporti hekurudhor të sigurt.	PO Projektligj për Autoritetin Kombëtar të	PO	PO	Po, ka ndikim në buxhetin e shtetit sepse

	aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore dhe detare		dhe Energjisë				investigimit të aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore			është institucion i ri.
19	Projektligj për ndarjen e Hekurudhës Shqiptare sh.a.	Projektligj	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Detyrim ligjor i BE-së	Rregullimi i kushteve dhe marrëdhënieve për menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore publike, për sipërmarrësit hekurudhore dhe hapjen dhe rregullimin e tregut hekurudhor.	PO Projektligj për Sipërmarrësit hekurudhore dhe për Administratorin e Infrastrukturës	PO	PO	JO
20	Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar"	Projektligj	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Ndryshimet e propozuara synojnë rregullime në ligjin ekzistues nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik të ndryshuar".	Ndryshimet e propozuara synojnë të rregullojnë procedurat e shpronësimit, me synim planifikimin, si dhe përqendrimin e kompetencave të institucionit përgjegjës për shpronësimet. Me këtë qëllim, do të ngrihet Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, e cila do të jetë institucion në varësi të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban. Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban, përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të saj.		JO	JO	JO
21	Projektvendim "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin"	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Një mekanizëm i ri ligjor i cili do të: Përqendrojë procedurat në një institucion të vetëm, duke saktësuar aspektet procedurale në fushën e shqyrtimit dhe trajtimit të kërkesave për shpronësim; Ul reagimin negativ të subjekteve duke negociuar dhe sqaruar me secilin prej tyre për kriteret, mënyrat, vlerësimin dhe gjithë procesin e shpronësimit në tërësi; Ul numrin e ankesave në gjykatë të subjekteve që do të shpronësohen; Ul borxhin aktual, me synimin e reduktimit final të tij, duke parashikuar dhe mundësuar pagesën me këste, kundrejt subjekteve të shpronësuara	Ngritja e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, si dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e kësaj agjencie	JO	JO	JO	PO, ka ndikim në buxhetin e shtetit sepse do krijohet institucion i ri

22	Projektvendim "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private", që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i rrugës "Isuf Balta", Tiranë""	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Ky projektvendim do të hapi rrugë për ndërtimin/rehabilitimin e zonës ku do të kryhet investimi publik.	Nëpërmjet këtij projektvendimi do të realizohet shpronësimi i pasurive të llojit "truall", me vlerë totale prej 51,306,408 (pesëdhjetë e një milionë e treqind e gjashtë mijë e katërqind e tetë) lekësh. Vlera totale e shpronësimit do të përballohet nga fondet e Bashkisë Tiranë.	JO	JO	JO	PO
23	Projektvendim "Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, pjesa e gjashtë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte"	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Nëpërmjet këtij gjen konkretizim Programi Politik i Qeverisë Shqiptare për mbështetjen e projekteve për diversifikimin e furnizimit të Shqipërisë me burime energjetike ku përfshihet edhe lidhja me rrjetet rajonale të gazit dhe zhvillimi në vend i sektorit të gazit, gjë e cila është në zbatim edhe të vizionit që përcakton kuadri ligjor për sektorin e gazit, ligji nr. 102/2015, datë 23.9.2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe është në përputhje me strategjinë sektoriale të këtij sektori.	Këto zhvillime mjaft pozitive në infrastrukturën ligjore, institucionale dhe teknike për sektorin e gazit do të bëjnë të mundur futjen e gazit si burim energjetik në ekonominë shqiptare dhe po ashtu edhe zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri, si dhe integrimin e mëtejshëm të sektorit energjetik shqiptar në kuadër rajonal dhe evropian.	JO	JO	JO	JO
24	Projektvendim "Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, pjesa e pestë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte"	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Nëpërmjet këtij gjen konkretizim Programi Politik i Qeverisë Shqiptare për mbështetjen e projekteve për diversifikimin e furnizimit të Shqipërisë me burime energjetike ku përfshihet edhe lidhja me rrjetet rajonale të gazit dhe zhvillimi në vend i sektorit të gazit, gjë e cila është në zbatim edhe të vizionit që përcakton kuadri ligjor për sektorin e gazit, ligji nr. 102/2015, datë 23.9.2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe është në përputhje me strategjinë sektoriale të këtij sektori.	Këto zhvillime mjaft pozitive në infrastrukturën ligjore, institucionale dhe teknike për sektorin e gazit do të bëjnë të mundur futjen e gazit si burim energjetik në ekonominë shqiptare dhe po ashtu edhe zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri, si dhe integrimin e mëtejshëm të sektorit energjetik shqiptar në kuadër rajonal dhe evropian.	JO	JO	JO	JO
25	"Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	iniciohet me qëllim njohjen, evidentimim dhe ruajtjen e të gjitha mjeteve rrugore që paraqesin një vlerë të shtuar për historinë e automobilizmit shqiptar, si dhe përcakton fushën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, kriteret e ngritjes dhe kushtet e funksionimit të	Përmes këtij projektakti synohet që t'u jepet një vlerë këtyre mjeteve, si dhe të promovojë pronarët ose poseduesit e tyre që të zhvillojnë pasionin e automobilizmit.	JO	JO	JO	JO

	së Shqipërisë				qendrave të kontrollit teknik të mjeteve rrugore në përputhje me ato të përcaktuara nga direktiva evropiane 2014/45/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit "Mbi kontrollin teknik periodik të mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre".					
26	Projektvendim "Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Teknik 2019 për projektin "Për një transport publik udhëtarësh miqësor me mjedisin në metropolin e Tiranës	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Miratimin në parim të marrëveshjes		JO	JO	JO	JO
27	Projektvendim "Për shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rrugët përgjatë Bregut Jugor të Rezervuarit të Banjës""‹	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Nëpërmjet këtij projektvendimi do të realizohet shpronësimi i pasurive të llojit tokë "Arë", "Truall" dhe "Kultura bujqësore".	Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 14,564,482 (katërmbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) lekësh do të përballohet nga fondet e Shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a.	JO	JO	JO	JO
28	Projektvendim "Për disa shtesa në vendimin nr. 368, datë 20.6.2018, të Këshillit të Ministrave "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi në zonën urbane pranë qendrës së Qytetit Vlorë", "Hartimi i projektit urban, Restaurimi i Monumenteve të	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Ky projektvendim do të hapi rrugë për ndërtimin/rehabilitimin e zonës ku do të kryhet investimi publik dhe kompensimin e pronarëve, pasuritë e të cilëve, preken nga projekti	kërkohet shpronësimi i disa pasurive shtesë, të cilat janë prekur nga realizimi i projektit "Hartimi i projektit urban, restaurimi i monumenteve të kulturës në këtë zonë dhe rikonstruksioni i objekteve të tjera, Vlorë", por në kohën e realizimit të procedurës së shpronësimit dhe miratimit të VKM-së, nuk ishin të pajisura me dokumentacion pronësie.	JO	JO	JO	JO

	Kulturës në këtë zonë dhe rikonstruksioni i objekteve të tjera, Vlorë									
29	Për përcaktimin e strukturës përgjegjëse dhe metodologjinë për verifikimin e plotësimit të kritereve të qëndrueshmërisë	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Detyrim i nenit 10 në rast miratimi të ligjit "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport", si dhe përafrim i nenit 18 të Direktivës 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 prill 2009, "Mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e energjive të rinovueshme", e cila shfuqizon Direktivën 2001/77/KE dhe Direktivën 2003/30/KE (*Verification of compliance with the sustainability criteria for biofuels and bioliquids*)	Do të miratojë strukturën përgjegjëse që do të verifikojë nëse operatorët ekonomikë kanë respektuar kriteret e qëndrueshmërisë. Do të përcaktojë mënyrën e verifikimit të Kritereve të Qëndrueshmërisë së Biokarburanteve të detyrueshme për operatorët ekonomikë: a) Të lejojnë që sasi të lëndëve të para ose biokarburante me karakteristika të ndryshme qëndrueshmërie të përzihen; b) Të informojnë mbi karakteristikat e qëndrueshmërisë dhe mbi volumet e përzierjeve të përmendura në pikën "a" dhe t'i mbajnë ato të pandryshuara; c) Të sigurojnë që shuma e sasive të përdorura nga përzierja të ketë njëjtat karakteristika të qëndrueshmërisë, sa shuma e të gjithave volumeve që i janë shtuar përzierjes.	Është parashikuar në procesin e hartimit të PKIE 2020–2022, kapitulli 15	2.2 Energjia dhe Burimet natyrore "Politika e Qeverisë në këtë mandat të ri do të vazhdojë të orientohet drejt rritjes të sigurisë së furnizimit me energji të konsumatorëve, duke pasur për objektiv mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet rritjes së punësimit dhe promovimit të energjisë së rinovueshme dhe eficiencës së energjisë, duke stimuluar konkurrencën në treg, duke siguruar stabilitet dhe minimizuar kostot për konsumatorët shqiptarë, si dhe duke garantuar mbrojtjen e mjedisit." *Si akt nënligjor i parashikuar të dalë pas miratimit të p/ligjit Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport"*	VKM-ja nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030" *Si akt nënligjor i parashikuar të dalë pas miratimit të p/ligjit Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport"*	PO
30	Projektvendim "Për miratimin e dokumentit të politikave spektrale 2020-2025"	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Përafrim me politikën spektrale të BE-së;	Dhënia e një plani afatgjate për përdorimin e spektrit të frekuencave - rritja e mundësisë për investime dhe përdorimit efektiv të spektrit të frekuencave	Po, kapitulli 10 "Shoqëria e informacionit dhe medias"	Ka përputhshmëria të projektaktit me programin politik qeverisës 2017–2021 konkretisht në pjesën **3.1.1 Administrata publike dhe digjitalizimi**	JO	JO
31	Projektligj "Mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik"	Projektligj	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	1. Plotësim kuadri ligjor 2. Transpozim Direktive të BE-së 3.Garantim i transparencës dhe llogaridhënies 4. Rritje e besimit të çdo individi tek organet e sektorit publik.	Heqjen e pengesave për ripërdorimin e informacionit në administratën publike, rritjen e cilësisë së shërbimit, si dhe lehtësimin e aksesit në një dokumentacion të kërkuar për t'u bërë i aksesueshëm më shumë se një herë.	Po, kapitulli 10 "Shoqëria e informacionit dhe medias"	Ka përputhshmëria të projektaktit me programin politik qeverisës 2017–2021 konkretisht në pjesën **3.1.1 Administrata publike dhe digjitalizimi**	Politika e të dhënave të hapura, miratuar me VKM-në nr. 277/2015.	JO
32	"Për miratimin në parim të Marrëveshjes Ndryshuese me shkëmbim letrash të Letërmarrëveshjes së Grantit nr.TF0A1769, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me shumë	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Parashikon miratimin në parim të marrëveshjes ndryshuese me Shkëmbim Letrash të Letërmarrëveshjes së Grantit nr. TF0A1769 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit të zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITI), ndryshim i cili konsiston në	Projektvendimi parashikon miratimin në parim të marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të letërmarrëveshjes së Grantit nr. TF0A1769 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit të zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITI), ndryshim i cili konsiston në ndryshimin e datës së mbylljes së grantit deri më 31 dhjetor 2020, me qëllim optimizimin dhe realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara. Kërkesa e palës shqiptare drejtuar BB, e cila synohet të miratohet në parim, i bashkëngjitet projektvendimit.	JO	JO	JO	JO

	Donatorë, për financimin e Projektit të Zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITI).				ndryshimin e datës së mbylljes së Grantit deri më 31 dhjetor 2020.					
33	"Për miratimin, në parim, të Dokumentit të Ndryshimit të Marrëveshjes së Huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për Rimëkëmbjen e Sektorit të Energjisë Elektrike, ratifikuar me ligjin nr. 170/2014.	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Synon miratimin, në parim, të Dokumentit të ndryshimit të Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, ratifikuar me ligjin nr. 170/2014, ndryshim i cili konsiston në: (a) Reduktimin e objektit të Projektit duke hequr disa aktivitete të parashikuara në marrëveshje; (b) Rishikimin e pagesave mujore të Huamarrësit për blerjen e energjisë dhe tarifës së transmetimit të KESH-it dhe OST-së; (c) anulimin e shumës prej 17.65 milion EUR nga Huaja e IBRD-së; (d) zgjatjen datës së mbylljes së projektit nga 30 nëntori 2019 deri më 30 nëntor 2020; (e) rishikimin e rezultateve të indikatorëve të projektit; me qëllim përfundimin e të gjithë aktiviteteve të komponentëve të Projektit të Rimëkëmbjes së Energjisë, si dhe shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 731, datë 13.11.2019.	Projektakti do t'i mundësojë Republikës së Shqipërisë përmbushjen dhe realizimin e angazhimeve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas nr. 8429-AL, me një vlerë totale 112.1 milion euro, nënshkruar në datën 3 nëntor 2014, si dhe angazhimeve të marra nëpërmjet këtij dokumenti ndryshues.	JO	JO	JO	JO
34	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 462, datë 9.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për regjistrimin e mjeteve lundruese në Republikën e Shqipërisë".	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Projektvendimit synon të plotësojë kuadrin ligjor në fushën e regjistrimit të mjeteve lundruese në Republikën e Shqipërisë. Projektvendimi ndryshon vendimin nr. 462, datë 9.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Për regjistrimin e mjeteve lundruese në Republikën e Shqipërisë".	Qëllimi i këtij projektvendimi është lehtësimi i procedurave të aplikimit për disa shërbime për regjistrimin e disa mjeteve lundruese dhe krijimit të lehtësive të subjekteve private për kryerjen e një procedure aplikimi sa më të thjeshtë dhe të shpejtë duke evituar radhët dhe pritjet e gjata pranë institucioneve që pranojnë aplikimet. Objekti i këtij projektvendimi është aplikimi vetëm nëpërmjet sistemit online nëpërmjet Portalit Qeveritar e-Albania për regjistrimin e mjeteve lundruese në Republikën e Shqipërisë. Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektvendimi janë:	JO	JO	JO	JO

						• Lehtësimi i procedurave të aplikimit për regjistrimin e mjeteve lundruese; • Reduktimi i kohës së aplikimit për regjistrimin e mjeteve lundruese e cila mund të bëhet vetëm për disa minuta nëpërmjet internetit. • Reduktimi i shpenzimeve të tepërta të subjekteve që duan të kryejnë regjistrimin e mjeteve lundruese dhe që ndodhen larg Zyrës së Regjistrit.				
35	"Për disa ndryshime në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i republikës së Shqipërisë", të ndryshuar	Projektligj	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	është propozuar si masë legjislative në Planin Kombëtar të Integrimit 2020–2022.	Akti i propozuar synon të ripërcaktojë afatet dhe frekuencën e kryerjes së kontrolleve teknike të mjeteve të reja rrugore dhe të përdorura në përputhje me ato të përcaktuara nga direktiva evropiane 2014/45/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit "Mbi kontrollin teknik periodik të mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre" dhe Rregulloren e Zbatimit të Komisionit Evropian 2019/621, e 17 prill 2019, "Mbi informacionin teknik të nevojshëm për kontrollin teknik të mjeteve rrugore/artikujt që do të testohen, duke përdorur metodat e rekomanduara të testimit dhe duke vendosur rregulla të detajuara në lidhje me formatin e të dhënave dhe procedurat për aksesimin në informacionin përkatës teknik."	JO	është propozuar si masë legjislative në Planin Kombëtar të Integrimit 2020–2022.	JO	JO
36	"Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e ndryshuar të organizatës evropiane të telekomunikacioneve satelitore (EUTELSAT)"	Projektligj	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Aktualisht Shqipëria është një nga pesë vendet që nuk kanë aderuar ende në Konventën e ndryshuar. Objekti i këtij projektligji është aderimi në Konventën e ndryshuar të Organizatës Evropiane të Telekomunikacioneve Satelitore (EUTELSAT) miratuar më 28 nëntor 2002.	Konventa e amenduar thekson detyrat e EUTELSAT dhe marrëdhënien e EUTELSAT me kompaninë EUTELSAT S.A. që kryen aktivitetin operacional në ofrimin e shërbimeve satelitore në të gjitha vendet evropiane. Konventa ruan në tërësi tekstin e Konventës së vitit 1985.	JO	Projektligji është në përputhje me angazhimet e Qeverisë për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria aderon. Miratimi i projektligjit nuk ka qenë parashikuar në planin e akteve analitike, por ka dalë si nevojë e përmbushjes së detyrimeve dhe angazhimeve ndërkombëtare në fushën e komunikimeve/telekomunikacionit, duke u sjellë në vëmendje të ministrisë nga EUTELSAT-i.	JO	JO
37	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 599, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i rrugës "Dhimitër Konomi", në zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë"	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Ky projektvendim do hapi rrugë për procedurën e shpronësimit për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 599, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i rrugës "Dhimitër Konomi", në zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë".	Ky shpronësim bëhet për përmbushjen e detyrimeve të Shtetit Shqiptar për realizimin e investimeve për interes publik.	JO	JO	JO	JO

38	"Për shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rikonstruksion i rrugëve, trotuarëve dhe ndriçimit në lagjen "30 Vjetori" (zona e ish-pjeshkores)""Berat	Projektvendim	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Ky projektvendim do të hapë rrugë për ndërtimin/rehabilitimin e zonës ku do të kryhet investimi publik dhe do të kompensohen pronarët për pasuritë e paluajtshme pronë private në vlerën totale prej 13 836 109.10 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e nëntë pikë dhjetë) lekësh.	Ky shpronësim bëhet për përmbushjen e detyrimeve të shtetit shqiptar për realizimin e investimeve për interes publik	JO	JO	JO	JO

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2020

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017–2021 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
55	Për funksionimin dhe përdorimin e TIMS (*Total Information Management System*)	Projektv endim	Ministri i Brendshëm	Katërmuj ori III	Rregullimin e përdorimin dhe mirëfunksionimin e TIMS ndërmjet ministrive/strukturave të ndryshme.	Krijimin e një baze ligjore që do të mundësojë krijimin dhe implementimin e një sistemi kërkimi të TIMS të vlefshëm për të gjitha strukturat/ ministritë.	Jo	3.1.1 Administrata Publike dhe Digjitalizimi	Nuk ka	Jo
56	Mbi caktimin e sektorëve të shërbimeve policore që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe fëmijës dhe	Projektv endim	Ministri i Brendshëm	Katërmuj ori III	Detyrim që lind nga pika 3 e nenit 64 të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar.	Përcaktimi i sektorëve të shërbimeve policore që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe fëmijës dhe përcaktimi i rregullave të veçanta për kushtet e punës për punonjëset e policisë që janë shtatzëna.	Jo	3.3 Shëndetësia dhe kujdesi social.	Nuk ka	Jo

	përcaktimi i rregullave të veçanta për kushtet e punës për punonjësët e policisë që janë shtatzëna									
57	Për armët	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Forcimi i politikave ndaj armëve të ligjshme dhe përputhja e legjislacionit me dhe Rregulloren nr. 258/2012, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e re të BE-së (2017/853/KE), të miratuar pas miratimit të ligjit nr. 74/2014, "Për armët".	Përcaktimi i kategorive të armëve, rregullave për dhënien e lejeve dhe autorizimeve për përdorimin, blerjen, importin dhe eksportin e armëve, pjesëve përbërëse të tyre, si dhe municioneve, si dhe përcaktimi i autoriteteve përgjegjëse.	Po, kapitulli 24	3.1 Shteti ligjor dhe drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	Jo	
58	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj, për periudhën 2021–2023	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Nisur nga fakti që Strategjia aktuale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme, Terrorizmit miratuar me VKM-në nr. 663, datë 17.7.2013, është e miratuar për periudhën 2013–2020, duhet të fillojë procesi i hartimit të Strategjisë për periudhën 2021–2026 dhe Planit të Veprimit për këtë periudhë.	Strategjia ka si qëllim të përcaktojë politikat, prioritetet strategjike në fushën e krimit të organizuar dhe trafiqeve të paligjshme, objektivat e institucioneve shtetërore që marrin detyrime në të, të harmonizojë e të ngrejë në një shkallë më të lartë koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të punës për arritjen e objektivave strategjikë për vitet 2021–2026.	Po, kapitulli 24	Lufta kundër krimit të organizuar	Jo	
59	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit 2021–2025 dhe Planit të Veprimit për vitet 2021– 2022 për zbatimin e Strategjisë Kundër Terrorizmit	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Ky projektakt propozohet me qëllim zbatimin e detyrimeve të Strategjisë kundër terrorizmit.	Ky projektakt parashikon të rregullojë, kohën, mënyrën, burimet njerëzore dhe ato financiare që do të nevojiten për zbatimin e strategjisë kundër terrorizmit.	Po, kapitulli 24	3.1 Shteti ligjor dhe drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	Jo	Jo
60	Për të huajt	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Projektligji propozohet të rishikohet në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit me *acquis* të Bashkimit Evropian, për kapitullin 24 "Drejtësia, liria dhe siguria".	Politikën e vizave, punësimit dhe qëndrimit të të huajve në RSH në përputhje me legjislacionin e BE-së të miratuara në këtë fushë.	Po, kapitulli 24	3. Shërbimet publike	Jo	Po, ndikim social, ekonomik dhe financiar
61	Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe Planit të Veprimit 2021–2027	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Përfundimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe Planit të Veprimit 2014–2020.	Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit është një dokument strategjik në përmbushje të objektivave madhorë të Qeverisë për arritjen e standardeve në kuadër të integrimit dhe anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Objektivat e përcaktuar në këtë dokument strategjik shkojnë në një linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe rekomandimet e BE-së për Shqipërinë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.	Po, kapitulli 24	3.1 Shteti ligjor dhe drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	Jo	

62	Përmirësimi i shërbimit të autotransportit në funksion të programit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë	Projektv endim	Ministri i Brendshëm	Katërmuj ori III	Në kuadër të ligjit 10173, datë 22.10.2009, "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", synohet shtimi në inventar i 4 (katër) automjeteve të blinduara që do të përdoren në funksion të masave së mbrojtjes fizike të personave të mbrojtur gjatë lëvizjeve për në organet e drejtësisë (për dhënien e dëshmisë) nga vendi i akomodimit.	Rregullimi i shërbimit të transportit, sipas standardeve të punës të njësive partnere të rajonit, në funksion të garantimit të jetës si të punonjësve të policisë dhe personave të mbrojtur.	Jo	Lufta kundër krimit të organizuar	Nuk ka	Jo
63	Për funksionet e Policisë Bashkiake	Projektv endim	Ministri i Brendshëm	Katërmuj ori III	Projektakti vjen në zbatim të ligjit për Policinë Bashkiake.	Ky projektakt do të rregullojë zbatimin e ligjit për Policinë Bashkiake.	Po	3.1. Shteti ligjor dhe drejtësia e re-Rendi dhe Siguria Publike.	Po	Jo
64	Për një ndryshim në VKM-në nr. 153, datë 7.4.2004, "Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor"	Projektv endim	Ministri i Brendshëm	Katërmuj ori III	Ndryshimet e rregullores janë rrjedhim i ndryshimeve të mundshme të Kodit Rrugor.	Ndryshimet do të prekin normat e sjelljes dhe disa nga normat e kapitullit të lejeve të drejtimit dhe të mjeteve.	Jo	3.1 Shteti ligjor dhe drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	Po	Po
65	Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Brendshme dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (e referuar në këtë dokument si SDC) që vepron ndërmjet Ambasadës së Zvicrës për Projektin Bashki të Forta	Projektv endim	Ministri i Brendshëm	Katërmuj ori III	Projektakti vjen në zbatim të ligjit "Për Policinë Bashkiake".	Ky projektakt do të rregullojë zbatimin e ligjit "Për Policinë Bashkiake".	Po	3.1 Shteti ligjor dhe drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	Po	Jo

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2020
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017–2021 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 79/2017, 'Për sportin'".	Projektligj	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori I	Rishikimi i ligjit në tërësi, në kuadër të përmirësimit të tij.	Nëpërmjet këtij projektligji synohet të rishikohen çështje, si: ndihmat apo sponsorizimet me materiale sportive, pajisje sportive, medikamente dhe pajisje të mjekësisë sportive në funksion të sportit, për organizatat sportive, të shtohet karta e tifozit etj.	Jo	Kapitulli 3.2 "Arsimi, rinia dhe sporti"	Jo	Ka ndikime sociale. Ka ndikime ekonomike/financiare. Nuk ka ndikime mjedisore.
2	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë për vitin 2020–2021".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori I	Detyrim ligjor.	Përcaktimi i kriterit të notës mesatare për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm.	Jo	Kapitulli 3.2 "Arsimi, rinia dhe sporti"	Jo	Ka ndikime sociale për studentët. Nuk ka ndikime ekonomike/ financiare. Nuk ka ndikime mjedisore.
3	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për kalimin në administrim të institucioneve të pronave të paluajtshme, në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre institucionet publike të arsimit të lartë, që i shërbejnë institucionit për të garantuar përmbushjen e misionit të tij".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori III	Detyrim ligjor.	Projektakti rregullon procesin e kalimit të pronave të paluajtshme, në administrim të IAL-ve, me qëllim përmbushjen e misionit të tyre.	Jo	Kapitulli 3.2 "Arsimi, rinia dhe sporti"	Jo	Nuk ka efekte financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Nuk ka efekte sociale.
4	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e llojeve të institucioneve/qendrave shëndetësore, publike apo private, si dhe kritereve që ato duhet të plotësojnë për lidhjen e marrëveshjeve me institucionet e arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori I	Detyrim ligjor.	Përcaktimi i kritereve specifikave për institucionet/qendrat shëndetësore, publike apo private për lidhjen e marrëveshjeve me institucionet e arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Nuk ka efekte sociale.
5	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për shpronësime në interes publik për ndërtimin e objekteve arsimore".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori III	Ofrimi i arsimit cilësor e gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Evropiane, ndërtime të reja, rehabilitim të objekteve arsimore.	Në zbatim të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", shpronësohen prona private me qëllim ndërtimin e objekteve arsimore, sipas nevojave të shprehura.	Jo	Jo	Jo	Ka efekte ekonomike dhe financiare. Ka efekte mjedisore.

										Ka efekte sociale.
6	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 483, datë 16.7.2014 të Këshillit të Ministrave "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori I	Vendimi aktual i fondit të ekselencës ka si bazë ligjore ligjin e vjetër të arsimit të lartë, tashmë të shfuqizuar. Për këtë arsye është parë i nevojshëm miratimi i një vendimi të ri, ku si bazë ligjore të shërbejë ligji aktual në fuqi për arsimin e lartë nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".	Projektvendimi synon dhënien e mbështetjes financiare për studentët me rezultate të shkëlqyera, të cilët synojnë të studiojnë jashtë vendit.	Jo	Jo	Jo	Ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
7	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për hapjen, riorganizimin ose mbylljen e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori III	Nëpërmjet aktit synohet hapja ose mbyllja e institucioneve private të sistemit arsimor parauniversitar.	Projektvendimi ka për qëllim hapjen ose mbylljen e institucioneve private të sistemit arsimor parauniversitar, sipas kërkesave të subjekteve të interesuara, në zbatim të nenit 42 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.	Jo	Jo	Jo	Ka efekte ekonomike dhe financiare. Ka efekte mjedisore, pasi hapja e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar sjell si rezultat ndërtimin e godinave të reja ku do të ushtrohet veprimtaria e tyre. Ka efekte sociale për nxënësit etj.
8	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për hapjen, mbylljen, ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori III	Nëpërmjet aktit synohet hapja/ mbyllja/riorganizimi i institucioneve të arsimit të lartë.	Projektvendimi ka për qëllim hapjen/ mbylljen/riorganizimin e institucioneve të arsimit të lartë, sipas kërkesave të subjekteve të interesuara, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".	Jo	Jo	Jo	Ka efekfe ekonomike dhe financiare. Ka efekte mjedisore, pasi hapja e IAL-ve sjell si rezultat ndërtimin e godinave të reja ku do të ushtrohet veprimtaria e tyre. Ka efekte sociale për studentët.
9	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e projektit pilot mbi masat për nxitjen e të nxënit, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve të shkollës 9-vjeçare "Naim Frashëri", Korçë, për vitin shkollor 2020–2021".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori III	Detyrim ligjor.	Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet mbështetja e projektit pilot mbi masat për nxitjen e të nxënit, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve të shkollës 9-vjeçare "Naim Frashëri" Korçë, për vitin shkollor 2020–2021. Projektakti rregullon masat për nxitjen e të nxënit, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve të shkollës 9-vjeçare "Naim Frashëri", Korçë.	Jo	Jo	Jo	Ka efekte financiare, të cilat do të mbulohen nga buxheti i MASR-së. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale për nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Naim Frashëri", Korçë, për vitin shkollor 2020–2021".
10	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për dhënien e bursave për nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer",	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori II	Detyrim ligjor.	Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet krijimi i mundësive për mbështetjen financiare të nxënësve të shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", Shkodër, si dhe implementimi i objektivave të qeverisë shqiptare për një zhvillim të qëndrueshëm të sistemit arsimor shqiptar	Jo	Jo	Jo	Ka efekte financiare të cilat do të mbulohen nga shteti austriak dhe shqiptar, bazuar në Marrëveshjen e nënshkruar

	Shkodër, për vitin shkollor 2020–2021".					dhe në veçanti arsimin profesional me synimin rritjen e shpejtë të përfshirjes së nxënësve në arsimin profesional në qarkun e Shkodrës.				ndërmjet palëve. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale për nxënësit e shkollës "Peter Mahringer", Shkodër.
11	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 531, datë 11.9.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori III	Mungesa e parashikimeve për programet e studimit të ciklit të tretë.	Ndryshimi i vendimit nr. 531, datë 11.9.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", konsiston kryesisht në përfshirjen e parashikimeve lidhur me programet e ciklit të tretë, si doktoratë, master ekzekutiv, specializimet afatgjata etj., parashikime të cilat në vendimin ekzistues mungojnë. Gjithashtu, akti duhet riparë në tërësi referuar Standardeve Evropiane të Cilësisë.	Po - kapitulli 26 "Arsimi dhe kultura"	Kapitulli 3.2 "Arsimi, rinia dhe sporti"	Jo	Ky projektvendim nuk ka efekte ekonomike dhe financiare shtesë për buxhetin e shtetit. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale për studentët.
12	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 14.11.2018, të Këshillit të Ministrave "Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori I	Përcjellja e kërkesave të vazhdueshme të sportistëve për shpërblim, sipas llojeve të sporteve dhe disiplinave që përfshijnë.	Përcaktimi i kritereve për shpërblim, sipas llojeve të sporteve dhe disiplinave që përfshijnë	Jo	Jo	Jo	Ky projektvendim ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
13	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar dhe procedurat e përjashtimit".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori II	Mungesa e bazës materiale dhe infrastrukturore në sistemin sportiv kombëtar.	Ky projektvendim synon rifreskimin e listës së materialeve sportive që zhdoganohen, duke u përjashtuar nga detyrimet doganore, në funksion të organizatave sportive ekzistuese dhe atyre të rejave.	Jo	Kapitulli 3.2 Arsimi, Rinia dhe Sporti	Jo	Ky projektvendim ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Nuk ka efekte sociale.
14	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Forcave të Armatosura si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me status të veçantë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare në Republikën e Shqipërisë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori I	Detyrim ligjor.	Projektvendimi synon të rregullojë çështjen e dhënies së statusit të veçantë për Akademinë e Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me status të veçantë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Nuk ka efekte sociale.
15	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për dhënien e statusit të veçantë, Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucion i arsimit të lartë publik në fushën sportit në Republikën e Shqipërisë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori I	Detyrim ligjor.	Projektvendimi synon të rregullojë çështjen e dhënies së statusit të veçantë për Universitetin e Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me status të veçantë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Nuk ka efekte sociale.
16	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për dhënien e statusit të veçantë, Universitetit të Arteve të Tiranës, si institucion i arsimit të lartë publik në fushën artit në Republikën e Shqipërisë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori III	Detyrim ligjor.	Projektvendimi synon të rregullojë çështjen e dhënies së statusit të veçantë për Universitetin e Arteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me status të veçantë në fushën e artit në Republikën e Shqipërisë.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Nuk ka efekte sociale.
17	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e krijimit, organizimit dhe funksionimit	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe	Katërmujori II	Detyrim ligjor.	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e procedurave të mënyrës së krijimit, organizimit dhe funksionimit të institucionit përgjegjës për rininë.	Jo	Jo	Jo	Ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore.

	të institucionit përgjegjës për rininë".		Rinisë							Ka efekte sociale.
18	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e anëtarëve, si dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori II	Detyrim ligjor.	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e anëtarëve, si dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
19	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, për t'u njohur si e tillë nga institucioni përgjegjës për rininë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori II	Detyrim ligjor.	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e kritereve që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, për t'u njohur si e tillë nga institucioni përgjegjës për rininë.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
20	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori II	Detyrim ligjor.	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë.	Jo	Jo	Jo	Ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
21	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori II	Detyrim ligjor.	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e rregullave të hollësishme për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
22	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 825, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve e të procedurave për dhënien e lejes për hapjen, mbylljen dhe funksionimin e institucioneve private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj", i ndryshuar.	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori I	Detyrim ligjor.	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e lejes për hapjen, mbylljen dhe funksionimin e institucioneve arsimore private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
23	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për një shtesë në vendimin nr. 649, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara", të ndryshuar".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori I	Detyrim ligjor.	Projektvendimi ka si synim përcaktimin listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
24	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar", të ndryshuar".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori I	Detyrim ligjor.	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e procesit të botimit, shtypjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar	Jo	Jo	Jo	Ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.

25	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori I	Detyrim ligjor.	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit.	Jo	Jo	Jo	Ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
26	Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2020 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori III	Detyrim ligjor.	Projektvendimi ka si synim rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2020 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për të mbuluar aktivitete të paplanifikuara apo situata emergjente.	Jo	Jo	Jo	Ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.

VENDIM
Nr. 169, datë 20.2.2020

PËR SHTRIRJEN, STRUKTURËN, PËRMBAJTJEN, METODOLOGJINË E PËRGATITJES DHE PROCEDURËN E DISKUTIMIT PUBLIK TË PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PASURIVE KULTURORE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 46, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Plani i menaxhimit të pasurisë kulturore është dokumenti bazë për menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm të pasurisë kulturore të paluajtshme.

2. Plani i menaxhimit ka për qëllim planifikimin, bashkërendimin e kompetencave të aktorëve që veprojnë në pasurinë kulturore, si dhe minimizimin e rreziqeve për vlerën kulturore, optimizimin e gëzimin e saj, duke ofruar kushte për akses, informim, ruajtje dhe mbrojtje.

3. Planet e menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme hartohen me qëllim:

a) propozimin e një modeli efektiv e të qëndrueshëm për menaxhimin e pasurisë kulturore;

b) hartimin e zbatimin e strategjive dhe të udhëzimeve për menaxhimin e vlerave kulturore, bazuar në praktikat më të mira të fushës;

c) administrimin efektiv të burimeve financiare;

ç) përcaktimin e një strukture administrative funksionale me staf të kualifikuar për menaxhimin e pasurisë kulturore.

4. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe/ose në bashkëpunim me institucionet e specializuara harton planet e menaxhimit, proces që drejtohet e bashkërendohet nga Instituti Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore (në vijim, IKTK), në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe me këtë vendim.

5. Plani i menaxhimit hartohet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me propozim/kërkesë nga partnerë/investitorë/donatorë, pasi partneri/ investitori/donatori është dakordësuar më parë me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

6. Për pasuritë kulturore të paluajtshme, në pronësi të subjekteve private apo në administrim të njësisë së vetëqeverisjes vendore, nisma për përgatitjen e planit të menaxhimit u takon këtyre të fundit, të cilët e përcjellin në strukturat përkatëse të ministrisë përgjegjëse për kulturën.

7. Në çdo rast, procesi i përgatitjes së draftit të planit të menaxhimit koordinohet e monitorohet nga IKTK-ja.

II. SHTRIRJA E PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PASURIVE KULTURORE TË PALUAJTSHME

1. Plani i menaxhimit konsiston në bashkërendimin në mënyrë efikase të burimeve të pasurisë kulturore në shërbim të përmbushjes së objektivave të planit për mbrojtjen e zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

2. Kohëzgjatja e planit të menaxhimit përcaktohet në varësi të objektivave që kërkohen të arrihen nëpërmjet tij. Në çdo rast, kohëzgjatja e një plani menaxhimi nuk mund të jetë më pak se 5 (pesë) vjet.

3. Plani i menaxhimit parashikon përmbushje të objektivave që ndahen në:

a) objektiva afatshkurtër;

b) objektiva afatmesëm;

c) objektiva afatgjatë.

III. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PLANIT TË MENAXHIMIT TË PASURISË KULTURORE TË PALUAJTSHME

1. Struktura e planit të menaxhimit përmban, por pa u kufizuar, si më poshtë vijon:

a) përmbledhjen ekzekutive;

b) hyrjen;

c) përshkrimin e pasurisë kulturore;

ç) vlerësimin e vlerave të pasurisë;

d) aspekte të tjera të lidhura me pasurinë;

dh)vizionin, qëllimin e objektivat;

e) administrimin e pasurisë kulturore;

ë) planin e veprimit;

f) zbatimin dhe monitorimin;

g) shtojcat.

2. Përmbajtja e planit të menaxhimit trajton, por pa u kufizuar, çështjet, si më poshtë vijon:

a) përmbledhjen ekzekutive, ku paraqitet shkurtimisht vizioni, qëllimi i planit të menaxhimit, objektivat, përmbajtja, si dhe propozimet e

aktivitetet kryesore që parashikohen të kryhen për periudhën kohore të vlefshmërisë së planit;

b) hyrjen, në të cilën paraqitet shkurtimisht nevoja për planin e ri të menaxhimit, metodologjia e përgatitjes, konsultimet e kryera me palët e interesuara, praktikat më të mira, analiza e legjislacionit në fuqi;

c) përshkrimin e hollësishëm të pasurisë kulturore, vlerat, gjendja e konservimit të tyre, karakteristikat, integriteti, autenticiteti, kufijtë, koordinatat gjeografike, të dhëna hartografike, të dhëna vizuale (fotografi ose skica), statusi ligjor që mbron pasurinë kulturore, çështje që lidhen me administrimin dhe udhëzime për adresimin e tyre;

ç) vlerësimin e vlerave kulturore, vlerave të jashtëzakonshme universale (nëse pasuria është pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s), vlerave të tjera të natyrave të ndryshme nga ajo kulturore, masat ruajtëse dhe mbrojtëse në funksion të vlerave;

d) aspekte të tjera të lidhura me pasurinë, si aspekte të zhvillimit social-ekonomik të komunitetit në dhe përreth pasurisë, turizmin, infrastrukturën dhe çështje të tjera të lidhura me pasurinë;

dh) vizionin, ku parashtrohet në mënyrë të përmbledhur ruajtja dhe zhvillimi i pasurisë, për një periudhë më të gjatë se afati i planit të menaxhimit në raport me strategjitë kombëtare, qëllimin dhe objektivat;

e) administrimin, ku analizohen në mënyrë të detajuar modelet e mundshme për menaxhimin sa më efikas të pasurisë kulturore të paluajtshme, duke propozuar alternativa zgjidhjeje, ndryshime dhe përmirësime të nevojshme në modelin aktual të administrimit në funksion të ruajtjes e mbrojtjes së autenticitetit dhe integritetit të vlerave kulturore, si edhe mbrojtjen e pasurisë kulturore nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;

ë) planin e veprimit, në të cilin paraqiten të gjitha masat dhe veprimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata që duhet të ndërmerren për përmbushjen e objektivave specifikë të planit të menaxhimit, si dhe përdorimin efikas të pasurisë kulturore të paluajtshme;

f) zbatimin e monitorimin, në të cilin përfshihen masat dhe indikatorët për monitorimin e zbatimit të planit të menaxhimit dhe të përmbushjes së objektivave të tij;

g) shtojcat, në të cilat përfshihen dokumente plotësuese apo mbështetëse që lidhen me pasurinë kulturore të paluajtshme, si: harta, akte ligjore e nënligjore në fuqi, plani i biznesit, plani i konservimit, dokumente të tjera, sipas rastit.

IV. METODOLOGJIA E PËRGATITJES SË PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PASURIVE KULTURORE TË PALUAJTSHME

1. Metodologjia për përgatitjen e planit të menaxhimit për pasuritë kulturore të paluajtshme synon unifikimin e hapave që kalon përgatitja e planit të menaxhimit, e cila përfshin, por pa u kufizuar, elementet e mëposhtme:

a) Analizën e integruar të pasurisë kulturore të paluajtshme, e cila përmban:

i. të dhënat e terrenit, dhe në rastin e vlerave të tjera të integruara me vlerat kulturore, të dhënat sipas karakteristikave të këtyre vlerave;

ii. analizën e vlerave kulturore, rëndësisë, integritetit, autenticitetit dhe të gjendjes së konservimit;

iii. analizën e vlerave të tjera të integruara me vlerat kulturore;

iv. analizën e kuadrit ligjor dhe institucional;

v. analizën e pikave të forta, dobësitë, mundësitë, kërcënimet e faktorëve që ndikojnë në ruajtjen e integritetit dhe autenticitetin e vlerave.

b) Hartimin e vizionit, i cili përmban:

i. investimin në ruajtjen e vlerave kulturore në funksion të mbrojtjes së integritetit, autenticitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve;

ii. modelin e administrimit të qenësishëm e funksional;

iii. bashkëpunimin institucional e ndërinstitucional efektiv;

iv. rritjen e kapaciteteve për të gjeneruar të ardhura dhe për të rritur fuqinë përthithëse të fondeve.

c) Planifikimin strategjik, i cili përmban:

i. përcaktimin e objektivave për mbrojtjen e vlerave kulturore dhe sigurimin e përfitimeve për shoqërinë, që duhet të jenë "të zgjuara", specifike, të matshme, të arritshme, të përshtatshme dhe të përcaktuara nga afate kohore;

ii. rezultatet e pritshme dhe treguesit mbi bazën e të cilëve do të matet suksesi ose dështimi i zbatimit të planit të menaxhimit.

ç) Planin e veprimit, i cili përmban:

i. aktivitetet specifike për realizimin e objektivave;

ii. rezultatet e matshme në terma konkretë, duke përcaktuar buxhetin;

iii. institucionet përgjegjëse për zbatimin, afatet kohore dhe burimet e nevojshme për realizimin.

d) Monitorimin e rishikimin e planit të menaxhimit, i cili përmban:

i. monitorimin e zbatimit të planit të menaxhimit;

ii. indikatorët dhe planet e veprimit të përcaktuar në planin e menaxhimit.

2. Plani i menaxhimit, në varësi të specifikës së pasurisë kulturore të paluajtshme, hartohet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me mbështetjen e:

a) institucioneve shtetërore të specializuara;

b) subjekteve të kontraktuara nga institucionet shtetërore të specializuara;

c) subjekteve të kontraktuara nga partnerë/investitorë/donatorë të mundshëm.

V. KONSULTIMI PUBLIK

1. Drafti i planit të menaxhimit është objekt i konsultimeve publike me institucione qendrore dhe vendore, grupe interesi të identifikuara dhe partnerë/investitorë/donatorë të mundshëm.

2. Konsultimi publik i draftit të planit të menaxhimit bëhet me grupe të ndryshme interesi, në të cilët duhet të përfshihen, por pa u kufizuar, si më poshtë vijon:

a) subjektet e përfshira në sistemin primar të menaxhimit të pasurisë kulturore (institucionet që kanë në pronësi dhe/ose administrojnë pasuritë kulturore);

b) pronarët e ligjshëm, të njohur brenda pasurisë kulturore;

c) strukturat shtetërore/subjektet që janë burime dytësore për menaxhimin e pasurisë kulturore (p.sh. këshillat vendorë kompetentë për menaxhimin e zonës së mbrojtur, administrata rajonale e zonave të mbrojtura, në rastet kur pasuria kulturore gjendet në zonë të mbrojtur mjedisore, dhe struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, kur pasuria gjendet në fondin pyjor e kullosor);

ç) komuniteti i zonës dhe grupe të tjera të interesuara (biznese, organizata jofitimprurëse apo donatorë të mundshëm).

3. Fazat e diskutimit publik të draftit të planit të menaxhimit përfshijnë:

a) publikimin e projektplanit të menaxhimit në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike dhe/ose faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

b) diskutimin publik të projektplanit të menaxhimit;

4. Publikimi i projektplanit të menaxhimit në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike dhe/ose faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore përfshin këto procedura:

a) ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore publikon në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike dhe/ose në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore projektplanin e menaxhimit;

b) palët e interesuara kanë të drejtë të dërgojnë në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore mendimet e rekomandimet e tyre rreth projektit të paraqitur brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga publikimi;

c) ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore shqyrton e vendos mbi mendimet dhe rekomandimet e paraqitura;

ç) plani i menaxhimit shoqërohet me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuara dhe, nëse nuk janë pranuar, një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre;

d) në rastin e pasurive me rëndësi universale, projektplani i menaxhimit i dërgohet për mendim edhe UNESCO-s.

5. Gjatë periudhës së publikimit sipas pikës 4, të këtij kreu, projektplani i menaxhimit i nënshtrohet diskutimit publik, sipas procedurave të mëposhtme:

a) ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore u njofton projektplanin e menaxhimit të pasurisë kulturore drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore (në vijim, DRTK) dhe institucioneve kompetente përkatëse, njësisë së vetëqeverisjes vendore të zonës, ku do të zhvillohet plani, si dhe grupeve e palëve të interesuara;

b) DRTK-ja dhe/ose institucionet kompetente përkatëse, që kanë në administrim pasurinë kulturore të paluajtshme, në bashkëpunim me njësinë e vetëqeverisjes vendore në territorin e të cilës ndodhet pasuria, cakton datën e zhvillimit të diskutimit publik dhe njofton grupet apo palët e interesuara dhe komunitetin nëpërmjet afishimit të njoftimit në zonën që preket nga plani;

c) në njoftimin për fillimin e procesit të konsultimit publik përcaktohen afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose

dërgojnë rekomandimet e tyre, si dhe referenca në faqen zyrtare të internetit të ministrisë, ku është publikuar projektplani i menaxhimit. Njoftimi publikohet edhe në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

ç) gjatë zhvillimit të takimit, përfaqësuesi i DRTK-së ose i institucionit kompetent përkatës mban procesverbal, në të cilin pasqyrohen të gjitha diskutimet, mendimet dhe rekomandimet e paraqitura. Listëprezenca firmoset nga të gjithë të pranishmit dhe i bashkëlidhet procesverbalit përkatës;

d) mendimet ose rekomandimet, listëprezenca dhe një kopje e procesverbalit i përcillen ministrisë ose IKTK-së;

dh) në përfundim të procesit, ministria ose IKTK-ja harton një përmbledhje të rekomandimeve të pranuara dhe, në rast të refuzimit të tyre, një përmbledhje të arsyeve të refuzimit.

6. Pas përfundimit të diskutimit publik të projektplanit të menaxhimit, vijohet me miratimin e tij, sipas parashikimeve të nenit 47, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

VI. DISPOZITAT E FUNDIT

Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe të gjitha institucionet publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 66, datë 24.2.2020

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT, "UDHA E SHKRONJAVE", TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikave 3 dhe 7 të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013 "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, "Udha e Shkronjave", Tiranë, për të gjitha nivelet arsimore (parashkollor dhe arsimi i mesëm i ulët).

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, "Udha e Shkronjave" ka këto detyrime:

a) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

c) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur që mund të ketë ndaj nxënësit;

d) të dorëzojë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer;

e) të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri, të mbulohen nga institucioni përkatës i arsimit parauniversitar privat.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, "Udha e Shkronjave", Tiranë, për të gjitha nivelet arsimore (parashkollor, dhe arsimi i mesëm i ulët);

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat;

d) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit për arkivat, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, "Udha e Shkronjave", Tiranë.

4. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personin juridik që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1, i cili nuk zbaton këtë urdhër.

5. Të gjitha aktet e licencimit të institucionit arsimor parauniversitar privat, "Udha e Shkronjave", Tiranë, për të gjitha nivelet arsimore (parashkollor dhe arsimi i mesëm i ulët), shfuqizohen.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe institucioni arsimor parauniversitar privat, "Udha e Shkronjave", Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

KËRKESË
Nr. 1996/1, datë 21.2.2020

PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rikonstruksion sheshi 'Ismail Qemali' dhe rruga 'Veterani', Bashkia Pogradec".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Pogradec.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Referuar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", i ndryshuar, personat e tretë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e plotësimit të afateve të publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është shpronësimit 4,107,226.5 (katër milionë e njëqind e shtatë mijë e dyqind e njëzetë e gjashtë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI "RIKONSTRUKSION SHESHI 'ISMAIL QEMALI' DHE RRUGA 'VETERANI', BASHKIA POGRADEC", ÇMIMI PËR PASURINË TRUALL ËSHTË LLOGARITUR SIPAS VKM-SË NR. 89, DATË 3.2.2016

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Zona kadastrale	N/pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ASHK-ja
1	Agim Muhamet Prishtina, Petrit Muhamet Prishtina, Bukurie Tosum Prishtina, Lumturie Muhamet Prishtina, Luiza Muhamet Prishtina, Argjen Muhamet Prishtina	8581	5/279	Truall	m²	391.5	10491	4,107,227	Konfirmuar nga ASHK-ja me shkresën nr.1266/1, datë 21.2.2019
SHUMA TOTALE E SHPRONËSIMIT						391.5		4,107,227	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 672 lekë